



ARSIM PËR PUNËSIM NË MAQEDONINË E VERIUT

Analizë e FINANCIMIT TË ARSIMIT DHE TRAJNIMIT JOFORMAL NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Shkup, 2019



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

Projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe
Bashkëpunim, i zbatuar nga HELVETAS Maqedonia
e Veriut, Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar
dhe Oda Ekonomike e Maqedonisë.

Analizë e
**FINANCIMIT
TË ARSIMIT
DHE TRAJNIMIT
JOFORMAL NË
REPUBLIKËN
E MAQEDONISË
SË VERIUT**

Shkup, 2019

Falënderim

Autorët u falënderohen të gjithë bashkëpunëtorëve të përfshirë në procesin e realizimit të hulumtimit, të cilët me përgjigjet e tyre mundësuan që të sigurohen të dhëna relevante për gjendjen. Falënderim të veçantë u drejtojmë ofertuesve të verifikuar, Agjencisë për Punësim të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Agjencisë për Punësim në Tetovë, Agjencisë për Punësim në Strumicë, Odës Ekonomike të Maqedonisë, si dhe ofertuesve të intervistuar në Shkup, Strumicë, Tetovë dhe Shtip.

Autorët i janë falënderues edhe Njesisë së Projektit të E4E@MK për këshillat praktike, dokumentet e siguruara plotësuese dhe për mbështetjen profesionale në procesin e hulumtimit dhe përpilimit të kësaj analize.

Autorë:

Dr. Misho Dokmanoviq
Dr. Darko Spasevski
Dr. Katerina Shapkova Kocavska
Mr. Sanja Giçevska

Përktheu:

Enis Misini

Kjo analizë është përpiluar nga Instituti për Hulumtime Strategjike dhe Edukim - IHSE.

Qëndrimet e shprehura në këtë dokument janë të autorëve dhe nuk është e thënë të përputhen me mendimet dhe politikën e Projektit, gjegjësisht me ato të organizatave që e implementojnë projektin dhe të donatorit.

Abstrakt

Në këtë dokument janë prezantuar konstatimet dhe rekomandimet kryesore lidhur me financimin e arsimit dhe trajnimit joformal në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të cilat rezultuan nga hulumtimi empirik i Institutit për Hulumtime Strategjike dhe Edukim – IHSE, krahasuar me periudhën nga dhjetori i vitit 2018 deri në mars të vitit 2019, e në kuadër të projektit “Arsim për Punësim në Maqedoni” (E4E@mk).

Në dokumentin janë përfshirë: metodologjia e hulumtimit të zbatuar (instrumentet për grumbullimin e të dhënave, korniza kohore dhe struktura e të anketuarve), trendet kryesore në zhvillimin e arsimit joformal dhe rezultatet nga hulumtimi i zbatuar në raport me financimin e arsimit joformal për të rritur. Këto të fundit kanë të bëjnë me çështjet që janë të lidhura me procesin e verifikimit, organizimit të procesit të arsimit joformal, përzgjedhjen dhe strukturën e pjesëmarrësve në trajnimet, bashkëpunimin me institucionet tjera, ndjekjen e cilësisë, gjithëpërfshirjes, si dhe financimit të arsimit dhe trajnimit joformal.

Shkurtesa

APRMV	Agjenci për Punësim e Republikës së Maqedonisë së Veriut
AMS	Agjencia për Mbështetjen e Sipërmarrësisë
KE	Komisioni Evropian
BE	Bashkimi Evropian
BNJVL	Bashkësia e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale
LARR	Ligji për Arsimin e të Rriturve
LUHC	Ligji për universitetet e hapura qytetare për mësim të përhershëm
MSHIA	Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MPPS	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
AJFRR	Arsim Joformal për të Rritur
PO	Plan Operativ për programe dhe masa aktive për punësim dhe shërbime në tregun e punës për vitin 2017
IEA	Institucionet dhe Entet Arsimore
QIR	Qendra Informative Rome
BB	Banka Botërore
OEM	Oda Ekonomike e Maqedonisë
ATP	Arsim dhe Trajnim Profesional
SHMP	Shkolla të Mesme Profesionale
QPS	Qendër për Punë Sociale
QATP	Qendër për Arsimit dhe Trajnim Profesional
QARR	Qendër për Arsimin e të Rriturve
UNDP	Program për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara

Përmbajtje

SHKURTESA	5
KONSTATIMET THEMELORE NGA HULUMTIMI	8
PARATHËNIE	19
1 METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	22
1.1. Të anketuar dhe instrumente për grumbullimin e të dhënave	23
1.2. Korniza kohore dhe struktura e të anketuarve	25
2 TRENDE KRYESORE NË ARSIMIN DHE TRAJNIMIN JOFORMAL.....	26
2.1. Trende në ofertën e programeve për arsim dhe trajnim joformal të të rriturve	28
2.2. Arsimit i personave të rritur.....	31
3 REZULTATE NGA HULUMTIMI I REALIZUAR NË RAPORT ME FINANCIMIN E ARSIMIT DHE TRAJNIMIT JOFORMAL PËR TË RRITUR.....	38
3.1. Procesi i verifikimit	39
3.2. Organizimi i procesit.....	43
3.3. Përzgjedhja dhe struktura e pjesëmarrësve në trajnime.....	48
3.4. Bashkëpunim me institucione të tjera	50
3.5. Ndjekje e cilësisë gjatë realizimit të programit për arsimin dhe trajnimin të rriturve	51
3.6. Praktika të mira	53
3.7. Gjithëpërfshirje e arsimit dhe trajnimit joformal	54
3.8. Financimi i arsimit dhe trajnimit joformal	57
BIBLIOGRAFI	67

The background of the entire page is a dense, repeating pattern of small, light gray icons. These icons represent a wide variety of concepts including science (lightbulbs, rockets, atoms), technology (laptops, gears, circuit boards), business (handshakes, briefcases, charts), education (graduation caps, books), and general human activity (running, thinking, social groups).

Konstatimet themelore **NGA HULUMTIMI**

Ky hulumtim kishte për qëllim që të analizojë gjendjen aktuale dhe sfidat, me fokus të posaçëm në kornizën ligjore, resurset dhe financimin e arsimit joformal në shtatë sektorë (shëndetësi dhe përkujdesje sociale, shërbime personale, hotelieri, sektor të bujqësisë, sektor ushqimor-teknologjik, makineri dhe sektor të makinerisë dhe elektroteknikës – IT profile) në katër rajone të planifikuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut (Juglindje, Jugperëndim, Pollog dhe Shkup). Sektorët dhe rajonet e përmendura janë në fokusin e projektit Arsim për Punësim në Republikën e Maqedonisë së Veriut E4E@mk, në fazën e tij të parë (prej marsit të vitit 2018 deri në mars të vitit 2022).

Më konkretisht, ky hulumtim në gjendjen fillestare ka përfshirë:

- 1)** Grumbullimin dhe analizimin e të dhënave për trendet aktuale në arsimin joformal në katër rajone të planifikuara në shtet (Juglindje, Jugperëndim, Pollog dhe Shkup);
- 2)** Analizimin e kornizës ligjore në të cilën realizohet arsimi joformal dhe formulimi i rekomandimeve për përmirësimin e tij për zhvillimin e shkathtësive profesionale;
- 3)** Grumbullimin dhe analizimin e të dhënave për financimin e arsimit joformal, resurset që janë në dispozicion, si dhe shpërndarjen/shfrytëzimin tyre.

Një pjesë e të dhënave të grumbulluara dhe analizuara sasiore, e veçanërisht të dhënat që janë të lidhura me financimin e AJFRR-së, kanë të bëjnë me vitin kalendarik 2017, para së gjithash për shkak se:

- ➔ 2017-a është vit para fillimit të projektit;
- ➔ Kërkesa për qasje deri te informaciont e karakterit publik ka të bëjë me një vit të tërë kalendarik; dhe
- ➔ Raportet financiare (bilanci i gjendjes dhe bilanci i suksesit /bilanci i të ardhurave dhe shpenzimeve) të zbatuesve të shërbimeve nga Regjistri qendror kanë të bëjnë me gjithë vitin kalendarik.

Komponenta specifike në këtë hulumtim ishin: procesi i verifikimit të ofertuesve dhe programeve në Arsimin Joformal të të Rriturve (AJFRR), organizimi i procesit të arsimit joformal, përzgjedhja dhe struktura e pjesëmarrësve në trajnimet, bashkëpunimi me institucionet tjera, sigurimi i cilësisë, praktikat e mira, gjithëpërfshirja, si dhe financimi i arsimit joformal.

Hulumtuesit me kënaqësi konstatojnë se nuk kanë vërejtur se janë dhënë përgjigje të përgjigjeve të pëlqyeshme sociale nga të anketuarit. Si kufizim kryesor me të

cilin është përballur ekipi hulumtues gjatë grumbullimit të të dhënave të nevojshme për analizën, ishte qasja e kufizuar deri te informacionet për strukturën e të ardhurave të përgjithshme të ofertuesve të trajnimeve. Është konstatuar përgjegjësi e dobët nga ana e ofertuesve lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me financimin privat të arsimit joformal të të rriturve në vitin 2017.

Në tabelën e mëposhtme, për secilin prej komponentëve të përmendur janë veçuar konstatimet dhe rekomandimet kryesore nga hulumtimi.

KOMPONENTË	KONSTATIME	REKOMANDIM
Verifikim	▶ Përveç rregullës ligjore me të cilën rregullohet ky segment është Ligji për arsimin e të rriturve. ▶ Ofertuesit kanë bashkëpunim të shkëlqyeshëm me QARR-in gjatë verifikimit të programeve. Sipas organizatave të intervistuar, Qendra u përgjigjet shpejtë propozimeve për programet e reja, ndërsa procedura në të shumtën e rasteve përfundon në periudhë prej 2-3 javëve. ▶ Ekziston mundësi për përmirësimin e bashkëpunimit të ofertuesve me MASH-in.	▶ Forcim të kapaciteteve për koordinim të QARR-it në raport me ofertuesit, MASH-in dhe rolin e saj në raport me APRMV-në. ▶ Përmirësim i procedurave në MASH me qëllim të rritjes së shpejtësisë së veprimit dhe të efikasitetit në pjesën e verifikimit të institucioneve për arsim dhe trajnim joformal. ▶ Thjeshtësim të procedurave përmes vendosjes së instrumenteve dhe platformave digjitale sipas shembullit të platformave tashmë ekzistuese (për shembull e-regjistrim i shoqatave tregtare). Në këtë mënyrë do të përshpejtohet procedura për verifikim dhe do të ulen shpenzimet për informimin e ofertuesve.

KOMPONENTË	KONSTATIME	REKOMANDIM
Verifikim	- Nga intervistat e realizuara imponohet konstatimi se çështja e zvarritjes së verifikimit dhe të licencimit të programeve duhet të zgjidhet sa më shpejtë që të jetë e mundshme. Ky proces ndikon dukshëm në mundësitë për planifikim të brendshëm afatmesëm dhe afatgjatë të ofertuesve. - Mungon strategji shtetërore e definuar qartë në raport me atë se kush është bartës i arsimit joformal. Për shkak të pjesëmarrjes së një numri të madh të subjekteve (MASH dhe MPPS para së gjithash, por edhe APRMV, QARR dhe vetëqeverisja lokale), ofertuesit përballen me situata kur proceset vazhdojnë dhe janë joefikase (për shembull, një subjekt është i obliguar për verifikimin e programeve, ndërsa më shumë subjekte janë përfshirë në procesin e verifikimit të ofertuesve).	- Përmirësim i qasjes deri te baza e të dhënave të programeve të verifikuara dhe institucioneve të verifikuara të kapshme në internet, si dhe përditësimin e vazhdueshëm të saj, ndërsa e gjithë kjo me qëllim të qasjes më të madhe dhe më të lehtë deri te informacionet për pjesëmarrësit në programet. Në mënyrë plotësuese, të bëhet ndërlidhje e kësaj baze me informacionet që do të vinin nga punëdhënësit ose nga APRMV-ja, e me qëllim që pjesëmarrësit në trajnimet të jenë të orientuar në mënyrë përkatëse në përzgjedhjen e trajnimit dhe të jenë të njoftuar me kërkesat e tregut të punës. - Nevojitet të vazhdohet kohëzgjatja e verifikimit (për shembull, një afat i përgjithshëm prej 5 viteve, ose afat më të gjatë për ato programe për të cilat nuk ka ndryshime në përmbajtjet, përderisa programet me ndryshime në përmbajtjet t'i nënshtrohen verifikimit të sërishëm). Në mënyrë plotësuese, me qëllim që të evitohen dilemat në raport me afatin e kohëzgjatjes së verifikimit, nevojitet të parashikohet një dispozitë e këtillë në Ligjin për arsimin e të rriturve, në vend se kjo të bëhet me rregulloren e QARR-it. Për këtë rregullore ekzistojnë edhe dilema nëse për miratimin e saj ka bazë në Ligjin për arsimin e të rriturve.

KOMPONENTË	KONSTATIME	REKOMANDIM
Organizim i procesit të arsimit joformal	▶ Ofertuesit në të shumtën e rasteve e bëjnë përpilimin e programeve të reja përmes vlerësimit individual pa u harmonizuar me parametrat për tregun e punës në APRMV ose pa vendosur komunikim me punëdhënësit. ▶ Është vërejtur inercion relevant i ofertuesve në raport me iniciativat për ndryshim ose për plotësim të programeve ekzistuese, si dhe gjatë propozimit të programeve të reja për arsimin e të rriturve. ▶ Nga aspekti i mënyrave në të cilat organizohet mësimi në arsimin joformal si metodë e bartjes së diturisë dhe të shkathtësive dominon mësimi i rregullt (mësim që nuk përfshin metoda bashkëkohore, siç janë mësimi konsultues-instruktiv, mësimi letërkëmbyes-instruktiv, mësimi i hapur, telemësimi, mësimi në distancë, mësimi multimediatik, etj.).	▶ Nevojitet qasje më proaktive e ofertuesve në raport me rinovimin e programeve ekzistuese, si dhe drejt zhvillimit të programeve të reja në përputhje me nevojat e tregut të punës. ▶ Ofertuesit duhet të jenë të nxitur që të shfrytëzojnë edhe mënyra të reja të bartjes së diturisë dhe shkathtësive. Para së gjithash duhet të shqyrtohen opsionet për mësim nga distanca dhe për mësim multimediatik (të parashikuara në LARR), por edhe inovacione të tjera të mundshme. ▶ Nevojitet vendosje e lidhjes direkte mes ofertuesve dhe punëdhënësve më të mëdhenj, me qëllim që të dhënat për profesionet e nevojshme të mbërrijnë drejtpërdrejt deri te ofertuesit; si dhe të vendoset planifikim më afatgjatë dhe partneritet në të cilin ofertuesit do të jenë në shërbim të punëdhënësve, ndërsa do të mundësohet edhe vetëqëndrueshmëri financiare e programeve që ofrohen nën kushtet komerciale pa mbështetjen e shtetit. ▶ Nevojitet vendosje e modeleve të reja të mbështetjes financiare të ofertuesve, që do të thotë ndarje të mjeteve për investime dhe pajisje të ofertuesve në vend të ndarjes së mbështetjes financiare për pjesëmarrësit në programet.

KOMPONENTË	KONSTATIME	REKOMANDIM
Organizim i procesit të arsimit joformal	▶ Për shkak të kapacitetit të kufizuar, ofertuesit nuk janë të sistemuar në mënyrë përkatëse kështu që ndodhë pjesëmarrësit në trajnime nga një qytet (ose vendbanim) të jenë të detyruar të udhëtojnë në qytet tjetër për të marrë pjesë në trajnim. ▶ Ofertuesit nuk kanë mjete të mjaftueshme me të cilat do të ndërmerrnin investime në pajisjen që është e nevojshme për organizimin e trajnimeve për profesione që kërkojnë teknologji të niveleve të larta dhe risi.	▶ Nevojitet të përpilohet strategji shtetërore për strukturën organizative të arsimit joformal, nën kushte të reviduara. ▶ Alternativat e mundshme janë: 1) arsimin joformal ta organizojnë shkollat e mesme profesionale, 2) arsimin joformal ta organizojnë qendra rajonale shtetërore ose 3) arsimin joformal ta organizojnë ofertues privatë. Kjo, duhet të korrespondojë me Strategjinë për arsimin e të rriturve 2019 – 2023, si dhe Konceptcionin për arsim joformal dhe për mësim joformale. ▶ Është i rekomandueshëm integrimi/ bashkimi i ofertuesve në nivel rajonal, përmes organizimit në formë të Qendrave ose ndonjë lloji tjetër të formave të organizimit. Gjithashtu, konsiderojmë se model i mirë që funksionon tradicionalisht në shtet janë universitetet qytetare për mësim të përhershëm. Si rezultat i kësaj, rekomandojmë forcimin e kapaciteteve të universiteteve qytetare për mësim të përhershëm për ofrimin e AJFRR-së dhe bashkëpunim me punëdhënësit. Ato janë të pranishme edhe në vendet më të vogla, kështu që do të rritej qasja deri te trajnimet që shpijnë drejt punësimit në mjediset rurale (ku edhe papunësia është më e madhe). ▶ Nevojitet të rritet numri i profesioneve. Për dallim nga Gjermania, ku ekzistojnë 8000 profesione, në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë evidentuar rreth 500 profesione.

KOMPONENTË	KONSTATIME	REKOMANDIM
Përzgjedhja dhe struktura e pjesëmarrësve në trajnimet	▶ Statistika tregon se për çdo pjesëmarrës në program të verifikuar, ofertuesit mesatarisht shërbejnë 1,5 pjesëmarrës të programit që nuk është i verifikuar në përputhje me normat ligjore. ▶ Në raport me ndjekjen dhe rregullsinë e vizitorëve të trajnimit, praktika tregon se vizitorët nuk heqin dorë nga trajnimi në të shumtën e rasteve për shkak të benefitit financiar. ▶ Në raport me kapacitetet e ofertuesve, është konstatuar se për profesionet specifike që shfrytëzojnë teknologji të larta, ofertuesit nuk kanë resurse, kapacitete të mjaftueshme për t'i organizuar. ▶ Në mënyrë plotësuese parashtrohet edhe dilema nëse për profesionet që përfshijnë teknologji të larta mentorët gjegjësisht trajnuesit kanë dituri dhe shkathtësi të mjaftueshme.	▶ Të edukohen pjesëmarrësit në trajnimet për përfitimet e tjera nga ndjekja e suksesshme e trajnimit, krahas kompensimit financiar nga ana e APRMV-së. ▶ Nevojitet qasje e organizuar për kombinimin e resurseve dhe kapaciteteve të më shumë ofertuesve me qëllim të sigurimit të trajnimeve të avancuara dhe intensive në aspektin teknologjik. ▶ Të përfshihen ofertuesit në procesin e përzgjedhjes së kandidatëve për trajnime. ▶ Të nxitet interesi te të rriturit, para së gjithash te të papunët për pjesëmarrje më të madhe në programet për trajnim për rikualifikim dhe për kualifikim plotësues.
Bashkëpunim me institucione të tjera	▶ Theks i veçantë në intervistat është vënë në nevojën e analizës më cilësore të nevojave të tregut të punës. ▶ Një pjesë e ofertuesve sugjeron se ekziston ndikim i fuqishëm politik në kompanitë dhe se kjo ka ndikim mbi dinamikën e zhvillimit të arsimit dhe trajnimeve joformale.	▶ Qasje gjithëpërfshirës gjatë zbatimit të analizave për nevojat e tregut të punës, si dhe rol të përforcuar të APRMV-së me përdorimin e veglave më të besueshme metodologjike. ▶ Institucionet kompetente të reagojnë ndaj keqpërdorimeve të ndikimit politik gjatë punësimit dhe arsimit.

KOMPONENTË	KONSTATIME	REKOMANDIM
Ndjekje të cilësisë	▶ Inkurajon fakti që madje 80 për qind e ofertuesve kanë sistem të përcaktuar dhe procedura për kontrollin e cilësisë. ▶ Sipas të dhënave që janë marrë nga APRMV-së, përqindja mesatare e punësimeve të pjesëmarrësve në masën për trajnim për profesione të kërkuara sa i përket arsimit joformal, arrin rreth 40 për qind, varësisht nga profesioni. ▶ Ofertuesit nuk kanë sistem për ndjekjen e ndjekësve të trajnimeve pas përfundimit të tyre.	▶ Përmes shfrytëzimit të veglave digjitale, të miratohen zgjidhje të caktuara (softuer i specializuar) me të cilin do të sigurohej mënyrë më transparente e shpërndarjes së mjeteve. ▶ Kontroll më i madh i zbatimit dhe cilësisë së trajnimeve, si dhe përmirësim të sistemit dhe procedurave që i shfrytëzojnë ofertuesit. Cilësia më e madhe e ofertuesve të jetë përparësi gjatë verifikimit të radhës. ▶ Përmirësim të kapaciteteve të institucioneve kompetente për mbikëqyrje inspektuese (ISHA) dhe mbikëqyrje profesionale (QARR). ▶ Forcim i monitorimit që e zbaton APRMV-ja.
Praktika të mira	▶ Si profile gjegjësisht trajnime më të suksesshme janë veçuar trajnimet për servisimin e makinave rrobaqepëse, si dhe për automekanik për automjete bashkëkohore. Gjithashtu, trajnimi i popullarizuar, që pjesëmarrësit e shikojnë si potencial për të shkuar jashtë vendit është përkëdhelës/e i/e personave të rritur. ▶ Ofertuesit që janë përfshirë në hulumtimin nuk kanë përvojë me organizimin e trajnimit për grup më të madh sipas masës së iniciatorit.	▶ Të nxivten histori të suksesshme dhe të promovohen më mirë në opinion. ▶ Të rinovohen procedurat për organizimin e trajnimeve me atë që do të lejohet dhe do të nxitet organizim i trajnimit sipas masës së vizitorëve, mes tjerash edhe përmes zhvillimit të kompetencave modulare në kuadër të një lloji të trajnimit.

KOMPONENTË	KONSTATIME	REKOMANDIM
Gjithëpërfshirje e procesit të arsimit joformal	▶ Më i dobët është integrimi në arsimin joformal i personave me pengesë. ▶ Gjithsej 46 për qind e të anketuarve janë përgjigjur se trajnimet e tyre janë të ndjekura nga ana e personave me status të pavolitshëm socio-ekonomik. ▶ Thuajse dy të tretat e ofertuesve që janë verifikuar në përputhje me LARR-in, kanë theksuar se në trajnimet që i organizojnë kanë marrë pjesë edhe persona që vijnë nga mjediset rurale. ▶ Më shumë se gjysma e ofertuesve janë përgjigjur se në trajnimet e tyre kanë marrë pjesë persona të përkatësisë etnike rome.	▶ Nevojitet të avancohet gjithëpërfshirja e personave nga grupet e marginalizuara, e para së gjithash të rritet pjesëmarrja e personave me pengesë në trajnimet e arsimit joformal. ▶ Në zhvillimin e programeve dhe masave të ardhshme, detyrimisht të mbahet llogari për qasje më të madhe të arsimit joformal për grupet e rrezikuara dhe për gjithëpërfshirjen e tyre. ▶ Të promovohen universitetet qytetare për mësim të përgjithshëm si ofertues që gjithnjë e më shumë janë të kapshëm në vendet më të vogla.
Financim i arsimit joformal	▶ Financimi i AJFRR-së është kryesisht shtetëror dhe zhvillohet kryesisht përmes PO-së. ▶ Gjithsej 987 persona kanë ndjekur programe të verifikuara për arsimin e të rriturve përmes APRMV-së në vitin 2017, në secilin prej rajoneve nga projekti E4E@mk. Gjithsej 562 persona kanë marrë pjesë në programe të paverifikuara përmes APRMV-së (duke përfshirë edhe personat që kanë ndjekur trajnim në kuadër të Komponentit C dhe Komponentit D të projektit IPA “Mbështetja për punësimin e të rinjve”).	▶ Nevojitet të nxitet iniciativa private, ofertuesit të organizohen në mënyrë të pavarur, t’i rinovojnë dhe financojnë trajnimet në arsimin joformal. ▶ APRMV-ja të vazhdojë të jetë e përfshirë përmes Planit operativ në financimin e arsimit joformal, por me tendencë që mbështetja shtetërore me kalimin e kohës të zvogëlohet dhe të zëvendësohet me arsim të qëndrueshëm joformal të financuar privatisht. ▶ Nevojitet promovim më adekuat i mundësive që i ofrojnë programet e financuara nga BE-ja, e të cilat kanë të bëjnë me arsimin joformal në vend.

KOMPONENTË	KONSTATIME	REKOMANDIME
Financim i arsimit joformal	▶ Në PO-në në vitin 2017 janë identifikuar pesë masa, gjegjësisht programe, që janë të lidhura në mënyrë direkte ose indirekte me AJFRR-në: trajnim për profesione të kërkuara; Projekti IPA “Mbështetje për punësimin e të rinjve” – Trajnime për profesione të kërkuara në tregun e punës; trajnim te ndonjë punëdhënës i famshëm; pilot-program për trajnimin për plotësimin e nevojave lokale nga fuqia e kualifikuar punëtore; dhe trajnim për zejtari. ▶ Në vitin 2017, në rajonet në interes të projektit E4E@mk, gjithsej 252 persona kanë marrë pjesë në trajnimin e organizuar në kuadër të ndonjërës prej pesë masave, gjegjësisht programeve nga PO-ja. Shuma e përgjithshme e mjeteve të paguara arrin 13.484.042 denarë, prej të cilëve 52,4 për qind u janë paguar realizuesve të trajnimeve, ndërsa 47,6 për qind pjesëmarrësve në trajnimet. Në mesatare, për një pjesëmarrës në trajnim në vitin 2017 janë paguar 53.508 denarë.	

Parathënie

Arsimi joformal ka potencial të madh për sigurimin e personave kompetentë për tregun në secilin shtet të zhvilluar. Arsimi joformal është jashtë sistemit të rregullt (formal) arsimor, por kjo është institucionalizuar, realizohet prej arsimtarëve ose ligjëruesve të kualifikuar profesional, ka program të përkufizuar arsimor dhe kontribuon drejt rritjes së diturive të individit. Ky lloj i arsimit paraqet instrument të rëndësishëm përmes të cilit, në afat relativisht të shkurtër, personat e papunë mund të zhvillojnë shkathtësi dhe kompetenca që do t'u ndihmojnë të jenë më konkurrent në tregun e punës.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut në zhvillimin e arsimit joformal ndikojnë shumë faktorë, në mesin e të cilëve janë: ulja e numrit të pjesëmarrësve, gjendja e keqe ekonomike në shtet, kompetenca e ndarë për sistemin mes më shumë institucioneve dhe në nivele të ndryshme, rregulla të paharmonizuara juridike dhe mungesa e zbatimit të plotë të tyre, mosinteresi i bashkësisë afariste për përfshirje dhe mbështetje më të madhe të AJFRR-së; por edhe proceset globale transformuese, e veçanërisht ndryshimet në llojin e vendeve të punës dhe në përmbajtjen e punës, ndryshimet në kërkesën për kualifikime, si dhe nevoja për shkathtësi të reja të rinjtë.

Në këtë lloj të arsimit, në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin 2012, filloi procesi i verifikimit të programeve të posaçme për arsimin e të rriturve (programe për arsim joformal), me të cilat pjesëmarrësit përvetësojnë kualifikim ose kualifikim të pjesshëm. Në vitin 2016 është përgatitur edhe Strategji për arsimin e të rriturve, në të cilën është identifikuar sfida e përqindjes jashtëzakonisht të ulët të pjesëmarrjes së të rriturve në arsimin joformal (vetëm 0.71% e popullatës së përgjithshme aktive kanë marrë pjesë në aktivitete arsimore jashtë sistemit të rregullt

arsimor në vitin 2015).¹ Kjo çështje është përcaktuar si prioritet edhe në dokumentin pak më parë të pranuar nacional “Strategji për arsimin për vitin 2018-2025 dhe Plan operativ”.²

Në kuadër të bashkëpunimit dhe mbështetjes shumëvjeçare nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) për Republikën e Maqedonisë së Veriut, në fillim të marsit të vitit 2018 filloi të realizohet projekti “Arsim për Punësim në Maqedoninë e Veriut”(E4E@mk)³. Qëllimi kryesor i Projektit është që të kontribuojë drejt punësimit më dinjitoz të të rinjve, e veçanërisht të grupeve të rrezikuara, në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme. Kjo pritet të arrihet përmes qasjes sistemore që do të synojë të sigurojë zhvillim të shkathtësive profesionale me orientim të tregut përmes arsimit dhe trajnimeve joformale, bashkëpunimit të përmirësuar mes arsimit të mesëm profesional dhe punëdhënësve veçanërisht në pjesën e mësimi praktik të nxënësve, si dhe përmes kornizës së përmirësuar ligjore për zhvillim të shkathtësive profesionale. Në fazën e tij të parë (2018 – 2022), në fokus të posaçëm të projektit janë shtatë sektorë (shëndetësi dhe përkujdesje sociale, shërbime personale, hotelieri, sektori bujqësor, sektori ushqimor-teknologjik, sektori i makinerisë dhe elektroteknikës – IT profile) në katër rajone të planifikuara në shtet (Juglindje, Jugperëndim, Pollog dhe Shkup). Projekti është i implementuar nga konzorciumi të cilin e përbëjnë interkorporata zvicerane Helvetas, Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar dhe Oda Ekonomike e Maqedonisë, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, Qendrën për Arsimin e të Rriturve, Qendrën për Arsim dhe Trajnim Profesional, sektorin e biznesit dhe shumë organizata të tjera relevante qeveritare dhe joqeveritare.

1 Strategji për arsimin e të rriturve viti 2016 – 2020, Shkup, 2016 e kapshme në http://www.mon.gov.mk/images/AE_STRATEGY_MK_Final_1-min.pdf[qasje më 22 shkurt 2019], faq. 13.

2 Republika e Maqedonisë, Strategji për arsim viti 2018-2025 dhe Plan operativ, e kapshme në <http://mrk.mk/wp-content/uploads/2018/10/Strategjija-za-obrazovanie-MAK-WEB.pdf>[qasje më 23 shkurt 2019]. faq. 15.

3 Në vazhdim të tekstit Projekti ose E4E@mk.

Projekti E4E@мке angazhon ekipin e Institutit për Hulumtime Strategjike dhe Edukim (IHSE) të përpilojë analizë të gjendjes aktuale dhe sfidave me fokus të veçantë në kornizën ligjore, resurset dhe proceset dhe kompetencat tjera në arsimin joformal. Analiza mbështetet në hulumtimin empirik të zbatuar gjatë periudhës prej dhjetorit të vitit 2018 deri në mars të vitit 2019.

Ky studim ndërlidhet me hulumtimin dhe studimin paraprak “Analizë e kornizës ligjore, resurseve dhe proceseve dhe kompetencave të tjera në sistemin e arsimit dhe trajnimit formal profesional në Republikën e Maqedonisë”, që u realizua në kuadër të projektit të njëjtë.

1

Metodologjia e
HULUMTIMIT

Gjatë vendosjes së metodologjisë së hulumtimit, autorët u nisën nga postulati se për përcaktimin e efikasitetit të politikave ekzistuese është me rëndësi të jashtëzakonshme të analizohen të dhënat sasiore dhe informacionet/qëndrimet dhe mendimet cilësore të kategorive të të anketuarve me të cilët kanë të bëjnë ato politika.

1.1. TË ANKETUAR DHE INSTRUMENTE PËR GRUMBULLIMIN E TË DHËNAVE

Duke marrë parasysh domosdoshmërinë e informacioneve sasiore dhe cilësore, për grumbullimin e të dhënave në hulumtimin janë përdorur pesë lloje të instrumenteve:

- (1)** kërkesa për qasje deri te informacionet e karakterit publik të dërguara deri te institucionet kompetente;
- (2)** pyetësor për anketë elektronike të ofertuesve të verifikuar që kanë qenë aktivë në vitin 2016 dhe 2017;
- (3)** pyetësor për intervistë gjysmë të strukturuar me përfaqësues të institucioneve kyçe në nivele të ndryshme;
- (4)** protokoll për analizë të raporteve financiare; dhe
- (5)** protokoll për analizë të dokumenteve që e rregullojnë sistemin.

Në tabelën 1 janë paraqitur më shumë informacione për secilin prej instrumenteve, të ndërlidhura me ekzemplarin në hulumtimin, si dhe pikën e përgjigjeve të marra.

TABELA 1. INSTRUMENTE PËR GRUMBULIMIN E TË DHËNAVE

INSTRUMENT	PËRSHKRIM I INSTRUMENTIT	DREJTUAR	PËRGJIGJE TË MARRA NGA
Kërkesë për qasje deri te informacionet e karakterit publik	▶ 35 pyetje që janë të ndërlidhura me financimin dhe me procesin arsimor	APRMV-së dhe 11 qendrave lokale për punësim	Për shkak të centralizimit të shërbimit, përgjigje në të gjitha pyetjet është marrë drejtpërdrejt nga APRMV-ja, duke përfshirë edhe ato për gjendjen në qendrat lokale
Pyetësor për realizues të verifikuar të trajnimeve në vitin 2017	▶ 33 pyetje ▶ pyetësi është dërguar përmes postës dhe përmes postës elektronike	15 ofertues	33% e ofertuesve
Pyetësor për realizues të verifikuar të trajnimeve në vitin 2016	▶ 25 pyetje ▶ pyetësor elektronik	70 ofertues	16% e ofertuesve
Intervistë gjysmë e strukturuar dhe sipas nevojës intervistë rrënjësore me përfaqësues të institucioneve kryesore	▶ prej 5 deri 10 pyetje të përgjithshme ▶ në mesatare rreth 10 pyetje specifike për institucionin	Intervista të realizuara me gjithsej 11 përfaqësues të APRMV-së, APRMV – Tetovë dhe Strumicë, Odës Ekonomike të Maqedonisë dhe 6 ofertuesve (në Shkup, Strumicë, Tetovë dhe Shtip).	
Raporte financiare (bilanc i gjendjes dhe bilanc i suksesit/ bilanc i të ardhurave dhe shpenzimeve) të realizuesve të trajnimeve	▶ listë e llogarisë së përpunuar vjetore të marrë nga Regjistri Qendror (bilanc i gjendjes dhe bilanc i suksesit)	Janë kërkuar dhe marrë balance për gjithsej 23 persona juridik (informacione për personat juridik që janë aktivë në sektorët dhe rajonet përkatëse paraprakisht janë siguruar nga Qendra për Arsimin e të Rriturve)	
Protokoll për analizimin e dokumenteve që e rregullojnë sistemin	Janë analizuar: ▶ 2 ligje ▶ 2 strategji dhe një dokument i konceptcionit ▶ Plani operativ i APRMV-së ▶ rregullativa, raporte dhe dokumente të tjera relevante ▶ anketë për arsimin e personave të rritur nga ESHS-ja, etj.		

1.2. KORNIZA KOHORE DHE STRUKTURA E TË ANKETUARVE

Anketa me ofertuesit (administrimi i pyetësorit anketues) është organizuar gjatë periudhës prej 11 janarit deri më 8 shkurt të vitit 2019. Pyetësorit iu përgjigjën 16 ofertues, prej të cilëve 11 të verifikuar në vitin 2016, ndërsa 5 ofertues të verifikuar në vitin 2017. Pjesa më e madhe e ofertuesve që iu përgjigjën pyetësorit gjenden në Rajonin e planifikuar të Shkupit (gjithsej 8), 3 ofertues ishin nga Rajoni i Pollogut, 2 ofertues nga Rajoni juglindor dhe 1 ofertues nga Rajoni jugperëndimor. Dy ofertuesit e mbetur nuk janë përgjigjur se cilit rajon të planifikuar i takojnë. Në raport me profilin arsimor, gjegjësisht profesionin që e ofrojnë, struktura e ofertuesve të përfshirë me anketën është si vijon:


TABELA 2. TRAJNIME QË I OFROJNË OFERTUESIT E VERIFIKUAR TË ARSIMIT JOFORMAL, SIPAS PROFILIT ARSIMOR /PROFESIONIT


PROFIL ARSIMOR / PROFESION	PËRQINDJE E OFERTUESVE
Shërbime personale	55,6%
Hotelieri	16,7%
Bujqësi	5,6%
Makineri	11,1%
Shërbime shëndetësore	5,5%
Nuk ka përgjigje	5,5%

Pyetjes së parashtruar se *sa është numri i të punësuarve në organizatën/ofertuesin*, janë përgjigjur 13 ofertues. Sipas përgjigjeve që janë marrë, në këta 13 ofertues janë të punësuar gjithsej 121 persona, ose mesatarisht, një ofertues ka 9 persona të punësuar.

Intervistat u realizuan gjatë periudhës prej 20 janarit deri më 7 mars të vitit 2019. Gjatë realizimit, kujdes i veçantë i kushtohet asaj që bashkëbiseduesit të kenë pozicion më të lartë në institucionin dhe të jenë të autorizuar të shprehin qëndrimin e tyre (drejtorë, udhëheqës të sektorëve, etj.) Krahas kësaj, kjo zgjedhje mundësoi përfaqësim të rajoneve të ndryshme të vendit, ndërsa përzgjedhja e bashkëbiseduesve është përshtatur me formatin dhe me kornizën kohore të hulumtimit.

Për nevojat e hulumtimit janë dërguar edhe disa kërkesa për qasje të lirë deri te informacionet e karakterit publik deri te institucionet kompetente në fushën e arsimit joformal.



A dense, repeating pattern of small, light gray icons covers the entire background. The icons represent a wide range of concepts: education (graduation caps, books, lightbulbs), technology (laptops, tablets, gears, circuit boards), industry (wrenches, hammers, factory buildings), and general progress (lightbulbs, gears, upward arrows).

2

Trende kryesore

NË ARSIMIN DHE TRAJNIMIN JOFORMAL

Sistemi i arsimit të të rriturve në Republikën e Maqedonisë së Veriut përbëhet prej tri formave: 1) arsim formal, 2) arsim joformal dhe 3) mësim informal. Arsimi formal i të rriturve është arsim i institucionalizuar, që zbatohet në institucione shtetërore dhe private si arsim i rregullt dhe i çrregullt, sipas planeve dhe programeve përkatëse mësimore.⁴ Arsimi joformal i të rriturve nënkupton procese të organizuara të mësimit të orientura drejt aftësimit të të rriturve për punë, për aktivitete të ndryshme sociale ose për zhvillim personal.⁵ Mësimi informal i të rriturve shënon aktivitete në të cilat të rriturit i pranojnë qëndrimet, vlerat pozitive, shkathtësitë dhe dituritë nga përvojat e përditshme, si dhe ndikime të tjera nga mjedisi i tyre.⁶

Në këtë kapitull janë paraqitur të dhëna dhe informacione relevante që kanë të bëjnë me trendet në ofertën e AJFRR-së prej 1.1. të vitit 2012 deri më 31.7. të vitit 2018, të siguruara nga Qendra për Arsimin e të Rriturve dhe nga Oda Ekonomike e Maqedonisë, si dhe të dhënat nga Anketa për arsimin e personave të rritur viti 2016.

4 Neni 3 nga Ligji për Arsimin e të Rriturve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 7/2008, 17/2011, 51/2011, 74/2012, 41/2014, 144/2014, 146/2015, 30/2016 dhe 64/2018).

5 *Ibid.*

6 *Ibid.*

2.1. TRENDE NË OFERTËN E PROGRAMEVE PËR ARSIM DHE TRAJNIM JOFORMAL TË TË RRRITURVE

Në arsimin joformal, personat e rritur mund të përsosin dhe të arsimohen përmes ndjekjes së programeve të posaçme për përvetësimin e diturive dhe shkathtësive. Gjatë periudhës prej 1.1. të vitit 2012 e deri më 31.7. të vitit 2018, Qendra për Arsimin e të Rriturve (QARR) ka verifikuar gjithsej 328 programe

nga të 15 profesionet në përputhje me Klasifikimin nacional të profesioneve⁷. Në tabelën në vazhdim janë prezantuar të dhënat për secilin program/profesion ndaras gjatë periudhës së viteve 2012 – 2018. Më së shumti programe janë verifikuar në vitin 2016 (gjithsej 73).

TABELA 3. NUMRI I PROGRAMEVE TË VERIFIKUARA NGA QARR-I SIPAS PROFESIONIT (VITI 2012 – 2018)

PROFESIONI	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	GJITHSEJ
Shëndetësi	2	1	1	4	5	3	4	20
Përpunim tekstili dhe lëkure	/	1	1	7	2	3	1	15
Grafikë	/	/	/	1	/	/	/	1
Elektroteknikë	1	2	/	1	7	3	/	14
Shërbime personale	9	5	9	17	21	18	5	84
Hotelieri-turizëm	2	2	4	8	2	7	2	27
Ndërtimtari	2	3	5	8	4	4	4	30
Komunikacion	3	1	/	1	7	3	4	19
Veterineri	/	3	/	/	/	/	/	3
Pylltari dhe përpunim të drurit	1	1	/	2	2	2	2	10
Kulturë fizike	/	/	/	1	/	1	2	4
Gjeologji – miniera	/	/	/	/	2	/	/	2
Kimi	1	2	1	3	3	3	2	15
Makinieri	2	4	7	8	8	4	8	41
Juridik	/	1	4	1	6	7	6	25
Tjetër	/	1	1	3	4	2	7	18
GJITHSEJ	23	27	33	65	73	60	47	328

Burimi: Qendra për Arsimin e të Rriturve (QARR).

Shënim: Të dhënat për vitin 2018 kanë të bëjnë me periudhën prej 1 janarit deri më 31 korrik të vitit 2018.

⁷ Klasifikim nacional i profesioneve. Shkup: Enti Shtetëror për Statistikë i Republikës së Maqedonisë, 2015. E kapshme në: <http://www.stat.gov.mk/KlasifikaciiNomenklaturi.aspx?id=15> [qasje më 10 mars të vitit 2019].

Vetëm 4 prej gjithsej 328 programeve kanë të bëjnë me persona me pengesa. Në vitin 2015 është verifikuar programi nga profesioni i shëndetësisë me titull terapeut për persona me shikim të dëmtuar.⁸ Në vitin 2016, janë verifikuar dy programe nga fusha e makinerisë, argon-saldues⁹ dhe instalues dhe montues për instalacion të ujës-jellësit¹⁰ dhe një program nga fusha e profesionit kimik-teknik, përpunues i brumrave¹¹, të dedikuara për personat më dëgjim të dëmtuar.

Numri më i madh i programeve të verifikuara prej vitit 2012 deri në vitin 2018 janë për shërbime personale (84), edhe atë gjatë periudhës prej vitit 2015 deri në vitin 2017 (17 programe, 21 programe dhe 18 programe në mënyrë përkatëse). Më pas vijojnë programet nga profesioni i makinerisë (41 programe) dhe nga ndërtimtaria (30 programe).

Gjatë periudhës prej vitit 2012 deri në vitin 2018, numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në programet që i ka verifikuar QARR-i arrin 2.518 persona. Pasqyrë e hollësishme e numrit të pjesëmarrësve sipas profesionit dhe sipas vitit në të cilin kanë marrë pjesë në programet është dhënë në Tabelën 4.

- 8 E kapshme në: <http://cov.gov.mk/course/масер-терапевт-за-лица-со-оштетен-ви/> [qasje më 20 mars të vitit 2019]
- 9 E kapshme në: <http://cov.gov.mk/course/модуларна-обука-за-аргон-заварувач-за/> [qasje më 20 mars të vitit 2019]
- 10 E kapshme në: <http://cov.gov.mk/course/инсталатер-и-монтер-за-водоводна-инст/> [qasje më 20 mars të vitit 2019]
- 11 E kapshme në: <http://cov.gov.mk/course/изработувач-на-бели-печива-за-лица-со-о/> [qasje më 20 mars të vitit 2019]




TABELA 4. NUMRI I PJESËMARRËSVE NË PROGRAME TË VERIFIKUARA SIPAS PROFESIONIT (VITI 2012-2018)

PROFESIONI	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	GJITHSEJ
Shëndetësi	/	17	10	54	59	205	125	470
Përpunim tekstili dhe lëkure	/	/	7	25	10	24	/	66
Grafikë	/	/	/	/	/	/	/	/
Elektroteknikë	/	10	/	5	/	/	20	35
Shërbime personale	23	20	63	27	271	463	100	967
Hotelieri-turizëm	/	21	7	31	48	58	/	165
Ndërtimtari	/	6	10	14	2	13	26	71
Komunikacion	/	14	/	28	13	/	/	55
Veterineri	/	/	/	/	/	57	/	57
Pylltari dhe përpunim të drurit	/	/	/	2	9	/	10	21
Kulturë fizike	/	/	/	/	22	16	/	38
Gjeologji – miniera	/	/	/	/	12	20	/	32
Kimi	8	/	14	10	10	/	/	42
Makineri	/	10	6	5	42	53	17	133
Juridik	/	/	/	71	17	90	105	283
Tjetër	/	/	14	18	51	/	/	83
GJITHSEJ	31	98	131	290	566	999	403	2 518

Burimi: Qendra për Arsimin e të Rriturve (QARR).

Shënim: Të dhënat për vitin 2018 kanë të bëjnë me periudhën prej 1 janarit deri më 31 korrik të vitit 2018.

Numri më i madh i pjesëmarrësve në programet e verifikuara është regjistruar në vitin 2017, kur janë trajnuar gjithsej 999 persona. Në raport me përzgjedhjen e profesionit, pjesëmarrësit tregojnë interesim më të madh për programe nga fusha e shërbimeve personale, më pas profesioni i shëndetësisë, juridik-ekonomik dhe hotelier. Kështu që, gjatë periudhës së analizuar, numri i pjesëmarrësve në programe për shërbime personale arrin

967 persona (më së shumti në vitin 2017–463), për profile të shëndetësisë 470 pjesëmarrës (205 në vitin 2017), për profile juridike-ekonomike 283 (105 në vitin 2018) dhe në fushën e hotelierisë dhe turizmit ka pasur 165 pjesëmarrës (më së shumti në vitin 2017– 58 pjesëmarrës).

Numri i përgjithshëm i trajnimeve të mbajtura nga ofertuesit e verifikuar nga QARR-i, prej vitit 2012 deri më 31 korrik të vitit 2018, arrin 225.

TABELA 5. NUMRI I TRAJNIMEVE TË
MBAJTURA NGA OFERTUESIT E
VERIFIKUAR (VITI 2012 – 2018)


VITI	NUMRI I TRAJNIMEVE
2012	4
2013	15
2014	16
2015	26
2016	60
2017	82
2018	46
GJITHSEJ	225

Burimi: Qendra për Arsimin e të Rriturve (QARR).

Shënim: Të dhënat për vitin 2018 kanë të bëjnë me periudhën prej 1 janarit deri më 31 korrik të vitit 2018.

2.2. ARSIM I PERSONAVE TË RRIUR

Me qëllim që të përcaktohen në mënyrë më të hollësishme situatat lidhur me aktivitetet arsimore në procesin e arsimit formal dhe joformal të personave të rritur¹², Enti Shtetëror për Statistikë në vitin 2016 realizoi një Anketë për arsimin e personave të rritur¹³. Krahasset në kuadër të kësaj ankete janë harmonizuar me standardet metodologjike dhe rekomandimet e Eurostatit, si dhe me rregullativat e Komisionit Evropian¹⁴. Anketa është planifikuar të realizohet një herë në pesë vite, e lidhur me këtë analizë përdoren konstatime të vitit 2006 (ndërkohë, në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk ka pasur aktivitete intensive që do të kishin ndikuar dukshëm në situatën, ndaj për pjesën më të madhe të konstatimeve konsiderohet se ende janë relevante në aspektin statistikor).



12 Në përputhje me metodologjinë që e shfrytëzon Enti Shtetëror për statistikë, kategoria e personave të rritur i përfshin personat që i takojnë grupit të moshës prej 25 deri 64 vjeç.

13 Anketa për arsimin e personave të rritur, 2016. Shkup, Enti Shtetëror për statistikë. E kapshme në: <http://www.stat.gov.mk/PrikaziPublikacija.aspx?id=78&rbr=680> [Qasje më 15 shkurt të vitit 2019]

14 Rregullativa e Komisionit (BE) nr.823/2010, nr.1175/2014 dhe Rregullativa (BE) nr.452/2008.

Sipas të dhënave të Entit Shtetëror për Statistikë që janë marra nga Anketa për arsimin e personave të rritur, numri i përgjithshëm i personave të moshës prej 25 deri 65 vjeç të cilët kanë ndjekur arsim formal¹⁵ në vitin 2016 arrin 47 082, në sistemin e arsimit joformal¹⁶ janë përfshirë gjithsej 12 2567 persona, deri gjithsej 795 089 persona janë përfshirë në mësimn informale¹⁷.

Lidhur me strukturën e moshës të personave të cilët kanë ndjekur arsimin joformal, pjesa më e madhe e tyre janë të moshës prej 25 deri 34 vjeç (38,5%), derisa më e vogël është përfshirja e personave të moshës prej 55 deri 64 vjeç (10,6%). Informacione të hollësishme për strukturën e moshës e personave të përfshirë në sistemin e arsimit joformal në vend janë paraqitur në tabelën e radhës.

TABELA 6. PERSONA TË CILËT KANË NDJEKUR ARSIMIN JOFOROMAL, SIPAS MOSHËS

MOSHA	NUMRI I PERSONAVE TË CILËT KANË NDJEKUR ARSIMIN JOFORMAL	PËRQINDJE E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM
25 – 34 vjeçar	47 168	38,5%
35 – 44 vjeçar	36 888	30,1%
45 – 54 vjeçar	25 544	20,8%
55 – 64 vjeçar	12 967	10,6%
GJITHSEJ	122 567	

Burimi: Anketë për arsimin e personave të rritur, Enti Shtetëror për Statistikë (2016).

15 Arsimi formal është arsim që është në përputhje me ligjet për arsim në vend (ligje për arsim fillor, të mesëm ose i lartë), arsimim i institucionalizuar si arsim i rregullt dhe i çrregullt. Që të përfshihet në arsimin e rregullt (formal), aktiviteti arsimor duhet të shpie drejt kualifikimit të pranuar nga pushteti nacional dhe të jetë pjesë e shkallës së strukturuar hierarkike të arsimit dhe trajnimit, gjegjësisht pjesë e sistemit arsimor të vendit, ndërsa me mbarimin e nivelit të caktuar të arsimit, personi merr dëftesë, diplomë ose ndonjë lloj tjetër të certifikatës (Anketë për arsimin e personave të rritur, 2016, faq. 8).

16 Arsimi joformal është arsimim i institucionalizuar (realizohet në universitete punëtore, shkolla për gjuhë të huaja, për kompjuterë, muzikë, valle, etj., ndërsa përfshin edhe pjesëmarrje në seminare, konferenca, punëtori, etj.), ndërsa realizohet me ndihmën e programit arsimor dhe arsimtarëve ose ligjëruesve të kualifikuar profesional, e që kontribuon në rritjen e diturive të individit, por është jashtë sistemit të rregullt arsimor (Anketë për arsimin e personave të rritur, 2016, faq. 8).

17 Mesimi informal është i qëllimshëm, por më pak e organizuar dhe strukturuar sesa arsimi formal dhe joformal (nuk është i institucionalizuar). Mund të përfshijë aktivitete për mësim në familje, në vendin e punës dhe në jetën e përditshme të çdo personi (p.sh., kërkim në internet për riparimin e ndonjë aparati në amvisëri, ndjekje të emisioneve dokumentare, lexim të revistave, librave, vizitë në muzeje, etj.) (Anketë për arsimin e personave të rritur, 2016, faq. 8).

Të dhënat që kanë të bëjnë me arsimin joformal, gjithashtu tregojnë edhe dallim të qartë në strukturën arsimore të shfrytëzuesve të këtij lloji të arsimit. Kështu, pjesa më e madhe e personave që ndjekin arsimin joformal, thuajse 61% e numrit të përgjithshëm, kanë mbaruar paraprakisht arsimin e lartë ose sipëror (cikli i parë, i dytë dhe i tretë i studimeve). Gjithashtu, është e madhe përqindja e personave me arsim të mbaruar të mesëm (36,4%). Të dhënat për përgatitjen shkollore të personave të moshës prej 25 deri 64 vjeç që janë shfrytëzues të sistemit të arsimit joformal janë paraqitur në Tabelën 7.

TABELA 7. PERSONAQË KANË NDJEKUR ARSIM JOFORMAL SIPAS PËRGATITJES SHKOLLORE

PËRGATITJE SHKOLLORE	NUMRI I PERSONAVE	PËRQINDJE E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM
Pa arsim, arsim të pambaruar fillor dhe arsim fillor	3 697	3%
Arsim të mesëm	44 558	36,4%
Arsim të lartë dhe sipëror	74 312	60,6%
GJITHSEJ	122 567	

Burimi: Anketë për arsimin e personave të rritur (2016).

Nga aspekti i aktivitetit ekonomik, pjesëmarrje bindshëm më e lartë e personave të punësuar, gjithsej 87,6 për qind e numrit të përgjithshëm të

personave të moshës prej 25 deri 64 vjeç të cilët kanë ndjekur arsim joformal. Kjo e dhënë është brengosëse nëse merret parasysh numri i të papunëve në Maqedoninë e Veriut dhe nevojat e tregut të punës nga njëra anë, si dhe mundësitë e volitshme për përvetësimin e kualifikimeve/shkathtësive për punësim përmes arsimit joformal që do të mund të shpiejnë drejt punësimit, nga ana tjetër.

TABELA 8. PERSONAQË KANË NDJEKUR ARSIMIN JOFORMAL SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK

STATUS I AKTIVITETIT EKONOMIK	NUMRI I PERSONAVE	PËRQINDJE E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM
Të punësuar	107 390	87,6%
Të papunë	6 370	5,2%
Popullatë joaktive	8 807	7,2%
GJITHSEJ	122 567	

Burimi: Anketë për arsimin e personave të rritur (2016).

Pjesa më e madhe e personave që kanë ndjekur arsim joformal vijnë nga mjediset urbane (93 839 persona gjegjësisht 77%), derisa pjesëmarrja e shfrytëzuesve të arsimit joformal nga rajonet tjera ka qenë 28 728 persona. Kjo mund të shpie drejt mbajtjes së llogarisë nga ofertuesit dhe vendimmarrësit për qasjen deri te arsimi joformal në mjediset rurale, ku edhe pozita socio-ekonomike e personave që do të mund të ishin shfrytëzues të AJFRR-së është më e keqe.

Nga aspektii i strukturës gjinore, pjesëmarrja e burrave është më e madhe sesa pjesëmarrja e popullatës femërore për 7,4 pikë procentuale.

TABELA 9. STRUKTURA GJINORE E SHFRYTËZUESVE TË ARSIMIT JOFORMAL

GJINIA	NUMRI I PERSONAVE	PËRQINDJE E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM
Burra	66 008	53,8%
Gra	56 560	46,2%
GJITHSEJ	122 567	

Burimi: Anketë për arsimin e personave të rritur (2016).

Në anketën për arsimin e personave të rritur janë dalluar disa lloje të aktiviteteve arsimore: 1) kurse, 2) punëtori dhe seminare, 3) trajnim në vendin e punës dhe 4) orë private. Meqë supozohet se një person i caktuar mund të vizitojë më shumë se një fushë të aktiviteteve në të njëjtën kohë, personat që kanë marrë pjesë në dy ose më shumë aktivitete për mësim joformal japin informacione të hollësishme lidhur me dy aktivitete të zgjedhura rastësisht. Pjesëmarrja në arsimin joformal sipas llojit dhe numrit të aktiviteteve arsimore është prezantuar në tabelën 10.

TABELA 10. PJESËMARRJE NË ARSIMIN JOFORMAL, SIPAS LLOJIT DHE NUMRIT TË AKTIVITETEVE ARSIMORE

LLOJE TË AKTIVITETEVE ARSIMORE	AKTIVITETI I PARË PËR MËSIM JOFORMAL (NUMRI I PERSONAVE)	AKTIVITETI I DYTË PËR MËSIM JOFORMAL (NUMRI I PERSONAVE)
Kurse	34 389	14 965
Punëtori dhe seminare	69 480	4 019
Trajnim në vendin e punës	41 483	21 758
Orë private	4 443	0
GJITHSEJ	122 567	50 779

Burimi: Anketë për arsimin e personave të rritur (2016).

Nga të dhënat e prezantuara në tabelën, mund të vërejmë se interesim më i madh ka ekzistuar për arsimin joformal të organizuar në formë të punëtorive dhe seminareve. Nuk është për t'u nënçmuar edhe numri i personave (gjithsej 63 241) aktiviteti i parë ose i dytë i të cilëve është trajnimi në vendin e punës, derisa më e vogël është nevoja për orë private.

Në tabelën 11 janë paraqitur të dhënat për numrin e personave shfrytëzues të AJFRR-së, sipas llojit të institucionit që ka qenë ofertues. Mund të konstatohet se thuajse gjysma (46,7 për qind) e numrit të përgjithshëm të shfrytëzuesve, ofertuesve për aktivitete arsimore janë institucione të verifikuara për arsim dhe trajnim joformal, si dhe punëdhënësit.

**TABELA 11. PJESEMARRJE NË ARSIMIN
JOFORMAL SIPAS LLOJIT TË
SUBJEKTIT/OFERTUESIT**

SUBJEKTI QË ZBATON AKTIVITETIN ARSIMOR	NUMRI I PËRGJITHSHËM I SHFRYTËZUESVE
Institucione për arsim formal	16 746
Institucione për arsim dhe trajnim joformal	42 058
Institucione komerciale ku nxënia dhe trajnimi joformal nuk janë veprimtaria kryesore	6 309
Punëdhënës	30 654
Organizata të punëdhënësve, oda ekonomike	11 236
Organizata jofitimprurëse (p.sh. shoqata kulturore, parti politike)	2 739
Individë (p.sh. studentë që ofrojnë orë private)	2 100
Institucione jotregtare ku nxënia dhe trajnimi joformal nuk janë veprimtaria kryesore (p.sh. biblioteka, muze, ministri)	5 517
Tjetër	4 204
GJITHSEJ (25-64)	122 567

Burimi: Anketë për arsimin e personave
të rritur (2016).

Evidencë personale për numrin dhe llojin
e programeve të vlefshme të enteve dhe

institucioneve të verifikuara për realizimin
e programeve të posaçme për arsimin
e të rriturve mbanë edhe Ministria e
Arsimit dhe Shkencës (MASH). Kështu, në
përputhje me të dhënat që janë marrë
nga Sektori për arsim të mesëm, arsimi
e të rriturve dhe nxënia e përjetshëm të
MASH-it: numri i përgjithshëm i ofertuesve
të verifikuar në vitin 2017 që kanë pasur
programe të vlefshme arrin në 62 subjekte,
derisa numri i përgjithshëm i programeve
arrin në 165. Me këtë rast, numri më i
madh i programeve të verifikuara janë
realizuar në Shkup, ndërsa pas tij vijnë
Manastiri dhe Tetova.






TABELA 12. KOMUNA E REALIZIMIT
TË PROGRAMIT

KOMUNA E REALIZIMIT TË PROGRAMIT	NUMRI I PËRGJITHSHËM I PROGRAMEVE
Manastir	23
Gostivar	3
Kavadar	2
KrivaPallankë	1
Krushevë	1
Kumanovë	5
Makedonska Kamenicë	1
Negotinë	9
Pehçevë	4
Prilep	3
Radovish	1
Resnjë	2
Shën Nikollë	1
Shkup	75
Strugë	2
Strumicë	5
Tearcë	1
Tetovë	16
Shtip	10
GJITHSEJ	165

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Lidhur me mënyrën në të cilën financohet pjesëmarrja në aktivitete arsimore, Anketa për arsimin e të rriturve për vitin 2016 për persona të moshës prej 25-64vjeç, tregoi se punëdhënësit janë ata që kanë financuar 76 për qind të pjesëmarrjes në programet për shkak të lidhshmërisë me punën.





3

Rezultate nga

**HULUMTIMI I
REALIZUAR NË
RAPORT ME
FINANCIMIN E
ARSIMIT DHE
TRAJNIMIT
JOFORMAL PËR
TË RRITUR**

Në këtë kapitull janë dhënë rezultatet për financimin e arsimit dhe trajnimit joformal në Republikën e Maqedonisë së Veriut që rezultuan nga hulumtimi i realizuar empirik, e të cilat janë marrë përmes të gjitha veglave hulumtuese. Konstatimet janë organizuar në disa fusha tematike: procesin e verifikimit, organizimin e procesit të arsimit joformal, përzgjedhjen dhe strukturën e pjesëmarrësve në trajnimet, bashkëpunimin me institucionet tjera, ndjekjen e cilësisë, gjithëpërfshirjes si dhe financimin e arsimit joformal. Këto çështje të rëndësishme janë analizuar përmes prizmës së burimeve të përmendura primare dhe sekondare të hulumtimit.

3.1. PROCESI I VERIFIKIMIT

Element të rëndësishëm në funksionimin e arsimit joformal paraqet verifikimi i programeve.

Rregulla themelore ligjore me të cilën rregullohet ky segment është Ligji për arsimin e të rriturve¹⁸. Në këtë kontekst, në përputhje me nenin 2, paragrafi 1, alinea 2 e këtij Ligji si ofertues, gjegjësisht ofertues të shërbimeve për arsimin e të rriturve, janë përcaktuar: 1) institucion për arsimin e të rriturve (shkollë, institucion i lartë arsimor, si dhe institucione të specializuara për arsimin e të rriturve) dhe 2) institucion për arsimin e të rriturve i përcaktuar si person juridik ose fizik që ka regjistruar veprimtari për arsimin e të rriturve. Në mënyrë plotësuese, ofertuesit gjegjësisht provajderët janë përpunuar në nenin 5 të këtij Ligji. Nga aspekti nomoteknik, është e rekomandueshme që këto dispozita, neni 2 (1) (2) dhe neni 5 të jenë të integruar në një normë të vetme. Si plotësim i kësaj, Universitetet e hapura qytetare janë ofertues i

18 „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 7/2008, 17/2011, 51/2011, 74/2012, 41/2014, 144/2014, 146/2015, 30/2016 dhe 64/2018

veçantë dhe janë rregulluar edhe me ligj të veçantë lexspecialis.¹⁹

Në kuadër të procesit të verifikimit, në përputhje me ligjet, ofertuesit në të shumtën e rasteve bashkëpunojnë me Qendrën për Arsimin e të Rriturve (QARR) dhe Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës (MASH). Me fjalë të tjera:

- ➔ Në përputhje me nenin 7 paragrafi 1 alinea 4, si dhe nenin 22 të Ligjit për arsimin e të rriturve, MASH-i bën verifikimin e institucioneve dhe enteve për arsimin e të rriturve;
- ➔ Në përputhje me nenet 21a dhe 21b, Qendra për arsimin e të rriturve bën verifikimin e programeve të veçanta për arsimin e të rriturve.

Në përputhje me Rregulloren për mënyrat e verifikimit të programeve të veçanta për arsimin e të rriturve të përpiluar nga QARR-i në vitin 2016, verifikimi i programeve bëhet për periudhë prej 3 viteve. Ligji për arsimin e të rriturve nuk përmban dispozitë me të cilën parashikohet afat i vlefshmërisë së programit, por kjo është rregulluar me Rregulloren e QARR-it. Meqë mungon dispozita në Ligjin për arsimin e të rriturve për afatin e vlefshmërisë së programit të verifikuar, parashtrohet pyetja për bazën ligjore për rregullimin e

afatit me rregullore²⁰. Kështu, mungesa e bazës ligjore e vë në pikëpyetje edhe Rregulloren e QARR-it. Për shkak të kësaj duhet të vendoset dispozitë e veçantë me të cilën do të rregullohet çështja e kohëzgjatjes së verifikimit të programit në vetë Ligjin për arsimin e të rriturve. Në këtë drejtim, e me qëllim që të lehtësohet procesi, do të ishte më adekuate nëse afati do të ishte më i gjatë, për shembull, së paku pesë vite, si afati për akreditimin e programeve studimore në arsimin sipëror. Në mënyrë plotësuese, rekomandohet që të vendoset edhe procedurë e shkurtuar, gjegjësisht procedurë e shpejtë për programet që nuk janë të ndryshuara në përmbajtje në krahasim me riakreditimin e fundit. Për ta, pas skadimit të vitit të pestë, riakreditimi mund të jetë deklaratë (informim) nga ofertuesi drejt QARR-it se programi nuk ka pësuar ndryshime dhe se vazhdon të punojë me programin e njëjtë.

Nga intervistat e realizuara mund të konstatohet se bashkëbiseduesit në Shkup, Strumicë dhe Tetovë në përgjithësi kanë qëndrime të harmonizuara se ***bashkëpunimi me QARR-in lidhur me verifikimin e programeve është i shkëlqyeshëm***. Sipas të intervistuarve, ***Qendra përgjigjet në mënyrë ekspeditive ndaj propozimeve të programeve të reja, ndërsa procedura në të shumtën e rasteve përfundon për një periudhë prej 2-3 javëve***.

19 Ligj për universitetet e hapura civile për mësim të përjetshëm („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 36/2011, 41/2014, 145/2015, 55/2016 dhe 64/2018)

20 Për shembull, afati për akreditim (riakreditim) të programeve studimore në arsimin sipëror është i rregulluar në mënyrë eksplicite në Ligjin për arsim sipëror (neni 48, paragrafi 1) alinea(6)) sipas të cilit “Këshilli për akreditim vendosë për akreditimin e programeve studimore për periudhën prej pesë viteve studimore”.

Nga ana tjetër, janë përmendur sugjerime për përmirësim në pjesën e bashkëpunimit dhe përfshirjes së Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe rolit të këtij institucioni në gjithë këtë proces. Në intervistat është theksuar se verifikimi i ofertuesve në Ministrinë ndonjëherë zgjatë edhe më shumë se 3 muaj, me çka faktikisht shkurtohet kohëzgjatja e verifikimit. Është përmendur një rast ku procedura në MASH ka zgjatur 7-8 muaj, gjë që e vështirëson shumë punën e ofertuesve. Nga intervistat e realizuara imponohet konstatimi se kjo çështje duhet të adresohet sa është e mundshme më shpejtë. Si një prej zgjidhjeve të mundshme do të mund të ishte vendosja e sistemit për sigurimin e cilësisë, i cili do

të përfshinte vetëvlerësimin e ofertuesit në periudhë të caktuar, si mbikëqyrje inspektuese dhe profesionale (të bazuara në tregues, kriterë dhe instrumente të përgatitura). Pas marrjes së raporteve dhe rekomandimeve pozitive, duhet të ketë mundësi për procedurë të shpejtuar për verifikim, gjegjësisht verifikim të sërishëm.

Përfundimisht, është bërë e ditur edhe në nevojën që verifikimet të zgjasin një periudhë më të gjatë kohore (për shembull 5 vite). Arsyeja plotësuese për këtë sugjerim ishte ajo se për shkak të kohëzgjatjes së madhe të procedurës, veçanërisht në MASH, realisht verifikimi barazohet në 2 vite.



TABELA 13. KONSTATIME DHE REKOMANDIME LIDHUR ME PROCESIN E VERIFIKIMIT

PROCES I VERIFIKIMIT	
KONSTATIME	REKOMANDIME
▶ Rregulla themelore ligjore me të cilën rregullohet ky segment është Ligji për arsimin e të rriturve. ▶ Ofertuesit kanë bashkëpunim të shkëlqyeshëm me QARR-in gjatë verifikimit të programeve. Sipas organizatave të intervistuar, Qendra u përgjigjet shpejtë propozimeve të programeve të reja, ndërsa procedura në të shumtën e rasteve përfundon për një periudhë prej 2-3 javëve. ▶ Ka nevojë për përmirësimin e bashkëpunimit të ofertuesve me MASH-in. ▶ Nga intervistat e realizuara imponohet konstatimi se çështja e zvarritjes së verifikimit dhe licencimit të programeve duhet të jetë e adresuar sa është e mundshme më parë. Ky proces ndikon në masë të konsiderueshme në mundësitë për planifikim afatmesëm dhe afatgjatë të brendshëm strategjik të ofertuesve. ▶ Mungon një strategji e definuar qartë shtetërore në raport me çështjen se kush do të jetë bartës i arsimit joformal. Si rezultat i kësaj, ndodhë që për shkak të pjesëmarrjes së një numri të madh të subjekteve (MASH-i dhe MPPS-ja para së gjithash, por edhe APRMV-ja, QARR-i dhe vetëqeverisja lokale), proceset të jenë më të gjata sesa afatet e parashikuara, të mos jenë mjaft efikase (për shembull, një subjekt është bartës i procesi gjegjësisht është i obliguar për verifikimin e programeve, ndërsa më shumë subjekte janë të përfshira në verifikimin e ofertuesve).	▶ Forcim i kapaciteteve për koordinimin e QARR-it në raport me ofertuesit, MASH-in dhe rolin e tij në raport me APRMV-në. ▶ Përmirësim i procedurave në MASH me qëllim të rritjes së shpejtësisë në veprimin dhe efikasitetit në pjesën e verifikimit të institucioneve për arsim dhe trajnim joformal. ▶ Thjeshtësim i procedurave përmes vendosjes së veglave dhe platformave digjitale sipas shembullit të platformave tashmë ekzistuese digjitale në Republikën e Maqedonisë (për shembull, e-regjistrimi i shoqatave tregtare). Në këtë mënyrë, do të përshpejtohet procedura për verifikim dhe do të ulen shpenzimet për informimin e ofertuesve. ▶ Përmirësim i qasjes përmes bazës së të dhënave të programeve të verifikuara dhe institucioneve të verifikuara e kapshme në internet dhe përditësimin e vazhdueshëm të saj, me qëllim që t'u lehtësohet pjesëmarrësve në programet qasja deri te informacionet. Nevojitet lidhje plotësuese e kësaj baze me informacione që do të vinin nga ana e punëdhënësve ose APRMV-së, e me qëllim që pjesëmarrësit në trajnimet të jenë të orientuar në mënyrë përkatëse në përzgjedhjen e trajnimit dhe të jenë të njoftuar me kërkesat e tregut të punës. ▶ Nevojitet të vazhdohet kohëzgjatja e verifikimeve (për shembull, të përcaktohet një afat i përgjithshëm prej 5 viteve; ose të jetë afati më i gjatë për ato programepërtë cilat nuk ka ndryshime në përmbajtjet, derisa programet me ndryshime në përmbajtjet t'i nënshtrohen verifikimit të sërishëm). Në mënyrë plotësuese, me qëllim që të evitohen dilemat lidhur me kohëzgjatjen e verifikimit, nevojitet të parashikohet një dispozitë e tillë në Ligjin për arsimin e të rriturve, në vend se të bëhet me Rregullore të QARR-it. Për Rregulloren ekzistojnë edhe dilema në drejtim të asaj nëse për miratimin e tij ekziston bazë në Ligjin për Arsimin e të Rriturve. ▶ Të fillojnë procese për sigurimin e cilësisë në AJFRR, si dhe të vihen në funksion proceset për vlefshmërinë e mësimit joformal dhe atij informal për të cilët, me mbështetje nga Fondacioni Evropian për Trajnim ETF, QARR-i ka filluar aktivitete që nga viti 2014.

3.2. ORGANIZIM I PROCESIT


Organizimi i procesit të arsimit joformal përfshin disa faza: iniciativë për programe të reja, promovim të programeve dhe realizim i vetë trajnimit joformal. Ky proces mund të jetë mjaft kompleks. Nga ofertuesit pritet që t'i ndjekin nevojat e tregut dhe në bazë të këtyre nevojave të zhvillojnë dhe të verifikojnë programe për arsim joformal. Në fazën e radhës ofertuesit drejtohen për mbështetje përmes Planit të veprimit. Nëse e sigurojnë, fillojnë me realizimin e trajnimeve dhe certifikimin formal të arsimit të përvetësuar.

Pikërisht këto çështje ishin edhe objekt i interesit tonë, veçanërisht mënyra në të cilën inkurajohen ofertuesit që të fillojnë programe të reja ose t'i ndryshojnë ato aktuale, si dhe mënyra në të cilën e organizojnë mësimin dhe komunikimin me pjesëmarrësit në trajnimet.

Nga anketa e realizuar elektronike me ofertues të arsimit joformal, mund të konstatohet se pjesa më e madhe e programeve që ofrohen janë vendosur me iniciativë të vetë ofertuesit (56 për qind e përgjigjeve). Një pjesë më e vogël e ofertuesve janë të motivuar nga punëdhënësit që të zhvillojnë dhe ofrojnë program (16 për qind). Pjesa e mbetur e programeve ka të bëjë me iniciativën e Agjencisë për Punësim, organeve tjera shtetërore ose donatorëve të huaj. Në raport me propozimin e programeve të reja, nga intervistat gjysmë të strukturuar është vërejtur se ofertuesit informacionet për nevojën e programeve të reja të arsimit joformal në të shumtën e rasteve i marrin përmes vlerësimit individual të nevojave të tregut. Ligji për arsimin e të rriturve përmban një definicion për programe të verifikuara, gjegjësisht të pranuar publikisht, që i përcakton si programe për arsim formal të të rriturve që i miraton ose aprovon organi kompetent shtetëror (neni 2, paragrafi 1, alinea 7), e të cilat kanë të bëjnë me programe për arsim fillor, të mesëm dhe sipëror të përshtatura për nevojat dhe mundësitë e të rriturve (neni 17, paragrafi 1).

**GRAFIKON 1. INICIATIVË PËR VENDOSJEN
E PROGRAMEVE PËR AJFRR**

Kush është
iniciator i
programeve
të vendosura
që i ofroni?



- me iniciativë të donatorit të huaj
- me iniciativë të ndonjë organi tjetër shtetëror
- me iniciativë të APRMV
- me iniciativë të një grupi të pjesëmarrësve të interesuar për trajnim
- me iniciativë të punëdhënësve
- iniciativë personale

Te ofertuesit vërehet inercion relativ në raport me iniciativat për ndryshimin ose për plotësimin e programeve ekzistuese për arsimin e të rriturve. Ndonëse nevojat e tregut, veçanërisht shtatë sektorët në fokus të këtij hulumtimi, supozojnë nevojën e rinovimit të vazhdueshëm dhe ndjekjes së të arriturave më të reja në fushat përkatëse, sipas përgjigjeve të të anketuarve, më pak se gjysma e ofertuesve (44 për qind) kanë propozuar njëfarë ndryshimi të programeve ekzistuese. Situata e ngjashme është konstatuar edhe për propozimin e programeve të reja për arsimin e të rriturve, ku 56 për qind e të anketuarve janë përgjigjur se ndonjëherë kanë propozuar program të ri për arsimin e të rriturve.


Ofertuesit planifikojnë që të fillojnë procedurë për verifikimin e serishëm në të shumtën e rasteve për programet ekzistuese. Vetëm në raste të veçanta mendojnë për ofrimin e programeve të reja dhe më inovative (për shembull, diagnostikues i rregullsisë). Pjesa më e madhe e ofertuesve, programet që i verifikojnë i përcaktojnë në bazë të

masave që janë përfshirë në programet shtetërore për mbështetje (në të shumtën e rasteve në Planin e veprimit të APRMV-së). Ky lloj i planifikimit do të thotë se ofertuesit janë të varur nga politikat shtetërore, gjegjësisht se ofertuesit në të shumtën e rasteve nuk tregojnë interes për të vendosur programe që do të kishin funksionuar mbi bazë komerciale dhe do të ishin të qëndrueshme përmes kompensimit të siguruar nga pjesëmarrësit në trajnimet.

Në raport me mënyrat në të cilat organizohet mësimi në arsimin joformal, sipas përgjigjeve të anketuarve, me 48 për qind, dominon mësimi i rregullt si metodë e bartjes së diturisë dhe shkathtësive të pjesëmarrësit në trajnimet, që rrallëherë përfshinë metoda bashkëkohore dhe bashkëvepruese të bartjes së diturisë. Ndonëse Ligji për arsimin e të rriturve parashikon edhe mënyra tjera kreative të organizimit të kohës dhe të mësimi, si për shembull mësimi konsultativ, mësimi i hapur, mësimi në distancë, mësimi multimediatik, etj., këto opsione janë të shfrytëzuara më pak.

GRAFIKON 2. LLOJE TË MËSIMIT PËR AJFRR

Në çfarë mënyre e realizoni mësimin në programin për arsimimin e të rriturve?



Nga ana e ofertuesve është vërejtur edhe fakti se mungon strategji e definuar qartë shtetërore në raport me çështjen se kush do të jetë bartës i arsimit joformal. Në këtë drejtim, janë përcaktuar disa alternativa në kuadër të intervistave si rekomandime: 1) arsimin joformal ta organizojnë shkollat e mesme profesionale, 2) arsimin joformal ta organizojnë qendrat rajonale shtetërore ose 3) arsimin joformal ta organizojnë ofertues privatë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për shkak të nevojës evidente që ofertuesit privat të mund t'i planifikojnë investimet e tyre afatgjate.

Interesante janë informacionet që janë marrë lidhur me pagesën e trajnimeve nga ana e pjesëmarrësve. Është vërejtur se ofertuesit përmbahen nga përgjigjja në pyetjen e parashtruar për lartësinë e kompensimit. Për këtë pyetje janë marrë përgjigje prej vetëm 8 ofertuesve, ndërsa gjysma e të anketuarve janë përgjigjur se ekziston obligim i pjesëmarrësve në trajnimet që të paguajnë një kompensim të caktuar për ndjekjen e trajnimit. Lartësia e kompensimit është e ndryshme te ofertues të caktuar.

Lidhur me këtë pyetje, një pjesë e përgjigjeve të marra ishin dhënë si kompensim i përgjithshëm për tërë trajnimin, ndërsa një pjesë e ofertuesve përgjigjeshin për lartësinë e kompensimit në nivel mujor. Përgjigjet e dhëna në këto pyetje nga tetë ofertuesit janë paraqitur në tërësi në vazhdim:

- ➔ I anketuari 1: 3.075 denarë (50 euro) për pjesëmarrës në muaj;
- ➔ I anketuari 2: Prej 9.600 deri 39.000 denarë;
- ➔ I anketuari 3: 6.000 denarë në muaj;
- ➔ I anketuari 4: Varet nga kohëzgjatja e trajnimit, lëvizin mes 9.225 denarë (150 euro) dhe 18.450 denarë (300 euro);
- ➔ I anketuari 5: Në vitin 2016 kishim trajnim promovues për drejtues të ekskavatorit, makinave ngarkuese dhe buldozherit, trajnimi ishte falas, pa kurrfarë kompensimi;
- ➔ I anketuari 6: 12.800 denarë;
- ➔ I anketuari 7: Prej 15.000,00 deri 48.000,00 denarë; dhe
- ➔ I anketuari 8: 24.000 denarë.

Për çmimet e trajnimit nuk mund të nxirret konstatim i përgjithshëm, mes tjerash edhe për shkak se ofertuesit nuk kanë dhënë informacion për kohëzgjatjen e trajnimit.

Është e domosdoshme për organizimin e procesit të arsimit joformal ekzistimi i kuadrit përkatës mësimor, gjegjësisht trajnues përkatës profesional që do të kishin punuar me pjesëmarrësit në arsimin e të rriturve. Angazhimi i kuadrit përkatës, investimi në përmirësimin e kompetencave të kuadrit trajnues, organizimit të ligjëratave dhe të provimeve, si dhe sigurimi i kushteve përkatëse të sigurisë, e gjithë kjo është e

ndërlidhur me resurse që të mundësohet zhvillim i papenguar i procesit. Përgjigjet e hollësishme lidhur me shpenzimet e ofertuesve janë paraqitur në tabelën në vazhdim.

TABELA 14. LLOJE TË SHPENZIMEVE NË BARRË TË OFERTUESVE

LLOJI I SHPENZIMIT	PO (% e ofertuesve)	JO (% e ofertuesve)
A keni shpenzim plotësues për përgatitjen dhe për përmirësimin e kompetencave të kuadrit mësimor/ trajnues që e keni përfshirë në punë me pjesëmarrësit në programet/ trajnimet për arsimin e të rriturve?	81,3%	18,8%
A keni shpenzime për organizimin dhe për mbajtjen e provimeve për kontrollin e diturisë, shkathtësive dhe aftësive të pjesëmarrësve në trajnimet tuaja?	87,5%	12,5%
A jeni përballur me shpenzime plotësuese që kanë të bëjnë me sigurimin e kushteve të sigurta për punë në kuadër të procesit të arsimit të rriturve?	56,3%	43,8%

Lidhur me përgatitjen e programeve, shumica e bashkëbiseduesve të intervistuar theksuan se kanë shpenzime plotësuese meqë për këtë angazhojnë persona të jashtëm profesional.

Lidhur me këtë, është me rëndësi të theksohet se një pjesë e ofertuesve nuk kanë ide konkrete si si do të ishin financuar pa mjetet që i marrin nga shteti. Gjithashtu, për mjetet që i siguron shteti nevojitet analizë e thellë e shpenzimeve reale për organizimin e trajnimit. Intervistat tregojnë se për disa profesione mjetet janë të mjaftueshme, për disa janë tepër pak nëse merren parasysh shpenzimet në investime dhe shpenzimet rrjedhëse, derisa për disa mjetet që ndahen janë më të larta se shumica që në kushte komerciale u ofrohen personave të tretë si kompensim për trajnimin. Në këtë drejtim, rekomandohet që të përpilohet një metodologji e veçantë për përcaktimin e shpenzimit për realizimin e trajnimeve, me qëllim që të arrihet racionalizim dhe efikasitet në shpenzimin e parave shtetërore.

TABELA 15. KONSTATIME DHE REKOMANDIME LIDHUR ME ORGANIZIMIN E PROCESIT TË AJFRR-SË

ORGANIZIMI I PROCESIT TË ARSIMIT JOFORMAL

KONSTATIME

- ▶ Ofertuesit në të shumtën e rasteve bëjnë përpilimin e programeve të reja të arsimit joformal përmes vlerësimit individual të nevojës pa u harmonizuar me parametrat e APRMV-së për gjendjen në tregun e punës ose pa vendosur komunikim me punëdhënësit.
- ▶ Ekziston inercion relativ i ofertuesve në raport me iniciativat për ndryshim ose për plotësim të programeve ekzistuese, si dhe për propozimin e programeve për arsimin e të rriturve.
- ▶ Nga aspekti i mënyrave në të cilat organizohet mësimi, si metodë e bartjes së diturisë dhe të shkathtësive dominon mësimi i rregullt (mësim që nuk përfshin metoda bashkëkohore siç janë mësimi konsultativ-instruktiv, mësimi letërkëmbyes-konsultativ, mësimi i hapur, mësimi televiziv, mësimi në distancë, mësimi multimediatik, etj.).
- ▶ Ofertuesit, për shkak të kapacitetit të kufizuar, nuk janë të sistemuar në mënyrë përkatëse, kështu që ndodhë që pjesëmarrësit në trajnime nga një qytet (ose vendbanim) të jenë të detyruar të udhëtojnë në qytet tjetër për të marrë pjesë në trajnim.
- ▶ Ofertuesit nuk kanë mjete të mjaftueshme me të cilat do të bënin investime në pajisje që nevojitet për organizimin e trajnimeve për profesionet që kërkojnë teknologji të larta dhe inovacion.

REKOMANDIME

- ▶ Nevojitet një qasje proaktive e ofertuesve në raport me rinovimin e programeve ekzistuese, si dhe ndaj zhvillimit të programeve të reja në përputhje me nevojat e tregut të punës.
- ▶ Ofertuesit duhet të jenë të nxitur të përdorin edhe mënyra të reja të bartjes së diturisë dhe të shkathtësive. Para së gjithash duhet të shqyrtohen opsionet për mësim në distancë dhe për mësim multimediatike (të parashikuara në LARR), por edhe inovacione tjera të mundshme.
- ▶ Nevojitet vendosje e lidhjes së drejtpërdrejt mes ofertuesve dhe punëdhënësve më të mëdhenj, me qëllim që të dhënat për profesionet e nevojshme të mbërrijnë drejtpërdrejt te ofertuesit; si dhe të vendoset planifikim më afatgjatë dhe partneritet në të cilin ofertuesit do të jenë në shërbim të punëdhënësve, ndërsa do të mundësohet edhe vetëmirëmbajtje e programeve që ofrohen në kushte komerciale pa mbështetjen e shtetit.
- ▶ Nevojitet vendosje e modeleve të reja të mbështetjes financiare të ofertuesve, që do të thonë ndarjen e mjeteve për investime dhe pajisje të ofertuesve në vend se ndarje të mbështetjes financiare për pjesëmarrësit në programet.
- ▶ Nevojitet të përpilohet strategji shtetërore për strukturën organizative të arsimit joformal, nën kushte të reviduara. Alternativat e mundshme janë: 1) arsimin joformal ta organizojnë shkollat e mesme profesionale, 2) arsimin joformal ta organizojnë qendrat rajonale shtetërore ose 3) arsimin joformal ta organizojnë ofertues privatë. Kjo, duhet të korrespondojë me Strategjinë për arsimin e të rriturve 2019 – 2023, si dhe me Konceptcionin për arsim joformal dhe për mësim informal.
- ▶ Është i rekomandueshëm integrimi/bashkimi i ofertuesve në nivel rajonal, përmes organizimit në formë të Qendrave ose ndonjë lloj tjetër të formave organizative. Gjithashtu, konsiderojmë se model i mirë që funksionon tradicionalisht në RMV janë universitetet qytetare për mësim të përjetshëm. Si rezultat, rekomandojmë forcimin e kapaciteteve të universiteteve qytetare për mësim të përjetshëm për ofrimin e AJFRR-së dhe bashkëpunim me punëdhënësit. Ato janë të pranishme edhe në vendet më të vogla, ndaj qasja deri te trajnimet që shpijnë drejt punësimit në mjediset rurale (ku edhe papunësia është më e madhe) do të ishte rritur.
- ▶ Nevojitet të rritet numri i profesioneve. Për dallim nga Gjermani, ku ekzistojnë 8000 profesione, në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë evidentuar rreth 500 profesione.

3.3. PËRZGJEDHJA DHE STRUKTURA E PJESËMARRËSVE NË TRAJNIME

Lidhur me hulumtimin, me rëndësi ishte edhe informacioni për numrin e pjesëmarrësve në trajnimet që kanë ndjekur trajnim gjatë një viti arrin 500 persona. Nga ana tjetër, numri i pjesëmarrësve në trajnim në programe që nuk janë të verifikuara në përputhje me Ligjin për Arsimin e të Rriturve, e të cilët kanë ndjekur trajnime gjatë vitit arrin në 749 persona. Kjo do të thotë se për secilin pjesëmarrës të programit të verifikuar, ofertuesit në mesatare shërbejnë 1,5 pjesëmarrës në program që nuk është i verifikuar. Nga aspekti i rregullsisë së ndjekësve të trajnimit, praktika tregon se ndjekësit nuk heqin dorë nga trajnimi (në të shumtën e rasteve për shkak të përfitimit financiar, me fjalë të tjera për rregullsi në trajnimin pjesëmarrësit marrin edhe mjete financiare).

Është ngritur edhe çështja nëse numri minimal i pjesëmarrësve në grup, që është parakusht për organizimin e trajnimit, është pengesë që të organizohen trajnime për ato profesione që nuk janë shumë aktuale dhe për të cilat më vështirë do të ishte formuar grup. Të anketuarit konsiderojnë se ky është faktor kufizues, kështu që rekomandohet për profesione që nuk janë shumë të popullarizuara (ndërsa janë të nevojshme) ose që kanë specifika të posaçme, numri minimal

i pjesëmarrësve në grup të mos jetë parakusht për organizimin e trajnimit. Në mënyrë plotësuese, për profesionet e këtilla ofertuesit do të mund të grupoheshin dhe trajnimet t'i organizojnë bashkërisht. Ky model i organizimit të trajnimeve do të ishte veçanërisht i volitshëm dhe me kosto efektive për mjediset e vogla lokale/rurale.

Në raport me kapacitetet e ofertuesve konstatohet se për profesionet specifike që janë të ndërlidhura me teknologji specifike dhe për të cilat nevojitet të zhvillohen shkathtësi specifike, ofertuesit nuk kanë resurse dhe kapacitete të mjaftueshme për t'i organizuar. Me fjalë të tjera, ofertuesit nuk posedojnë pajisje përkatëse meqë furnizimi i kësaj pajisjeje paraqet barrë për ta, ndërsa kompanitë/punëdhënësit nuk janë të hapur sa duhet për bashkëpunim. Gjithashtu, u imponua edhe dilema nëse për profesionet që përfshijnë teknologji të larta, mentorët gjegjësisht trajnuesit kanë dituri dhe kapacitete të mjaftueshme.

Në kuadër të intervistave të realizuara, u hap edhe çështja e mënyrës së përzgjedhjes së ndjekësve të trajnimit. Lidhur me këtë, një pjesë e ofertuesve konsiderojnë se ndjekësit e trajnimeve duhet t'i përzgjedhin ofertuesit e tyre ose ofertuesit të marrin pjesë në përzgjedhjen e tyre bashkë me Agjencinë për Punësim.

Lidhur me lokacionin ku realizohet trajnimi, duhet theksuar se, në të shumtën e rasteve ofertuesit ofrojnë programe për arsim joformal në një qytet. Shembull pozitiv është një ofertues që ofron programe në 7 komuna dhe 11 pika.

Përfundimisht, në pjesën e realizimit të trajnimit duhet të veçohet edhe fakti se pagesa e ofertuesve dhe ndjekësve është bërë rregullisht.

Me ofertuesit u diskutuan edhe çështje të përgjithshme, si për shembull orientimi i tregut: nëse programet për arsim joformal (po edhe për arsim formal) e ndjekin ristrukturimin real të ekonomisë së Maqedonisë; politikat nacionale për

tërheqjen e investorëve të huaj; nëse merren parasysh profesionet e kërkuara nga investorët e huaj dhe ngjashëm. Lidhur me këtë është veçanërisht i rëndësishëm konstatimi se mungon lidhja e drejtpërdrejt mes ofertuesve dhe investorëve të huaj, ndërsa rezultat i kësaj është mundësia e zvogëluar për planifikim dhe partneritet të përbashkët.

TABELA 16. KONSTATIME DHE REKOMANDIME LIDHUR ME PROCESIN E PËRZGJEDHJES SË PJESËMARRËSVE NË TRAJNIMET DHE STRUKTURËN E PJESËMARRËSVE

PËRZGJEDHJEDHE STRUKTURË E PJESËMARRËSVE NË TRAJNIME

KONSTATIME

- ▶ Statistika tregon se për secilin pjesëmarrës të programit të verifikuar, ofertuesit në mesatare shërbejnë 1,5 pjesëmarrës në program që nuk është i verifikuar në përputhje me normat ligjore.
- ▶ Në raport me rregullsinë e ndjekësve të trajnimit, praktika tregon se ndjekësit nuk heqin dorë nga trajnimi në të shumtën e rasteve për shkak të përfitimit financiar.
- ▶ Në raport me kapacitetet e ofertuesve konstatohet se për profesionet specifike që përdorin teknologji të larta, ofertuesit nuk kanë resurse dhe kapacitete të mjaftueshme për t'i organizuar.
- ▶ Në mënyrë plotësuese imponohet edhe dilema nëse për profesionet që përfshijnë teknologji të larta, mentorët gjegjësisht trajnuesit kanë dituri dhe shkathtësi të mjaftueshme.

REKOMANDIME

- ▶ Të edukohen pjesëmarrësit në trajnimet për përfitimet tjera nga ndjekja e suksesshme e trajnimit (krahas kompensimi financiar nga APRMV-ja), e para së gjithash për mundësinë e punësimit dinjitoz.
- ▶ Nevojitet qasje e organizuar për kombinimin e resurseve dhe kapacitetet të më shumë ofertuesve me qëllim të sigurimit të trajnimeve intensive të avancuara dhe teknologjike, si dhe kombinim i trajnimeve, veçanërisht për grupet që kanë pjesëmarrës nën minimumin.
- ▶ Ofertuesit të përfshihen në procesin e përzgjedhjes së kandidatëve për trajnime.

3.4. BASHKËPUNIM ME INSTITUCIONE TË TJERA

Në një pjesë të konsiderueshme të intervistave është theksuar nevoja e bashkëpunimit më të mirë me autoritetet lokale, me projektet që punojnë në këtë fushë, si dhe me kompanitë lokale. Në këtë drejtim, është theksuar edhe përvoja pozitive e UHCNP-Tetovë, e cila ka pasur bashkëpunim të shkëlqyeshëm të vendosur me kompanitë Ekolog dhe Jugohrom.

Theks i veçantë nga të gjithë bashkëbiseduesit e intervistuar ishte vënë në nevojat e tyre për analiza më cilësore të

kërkesave të tregut të punës. Thuajse të gjithë bashkëbiseduesit e theksuan nevojën për ndjekje më aktive të gjendjes në tregun e punës. Në këtë drejtim, është potencuar se mungesa e analizës cilësore të nevojave të tregut të punës i zvogëlon mundësitë e tyre si ofertues që të bëjnë një ofertë më adekuate të trajnimeve. Është përmendur edhe ajo se plani operativ nuk i plotëson në tërësi kërkesat e tregut.

Megjithatë, një pjesë e ofertuesve sugjeron se ekziston ndikim i fuqishëm politik në kompanitë dhe se kjo ka ndikim mbi dinamikën e zhvillimit të arsimit dhe trajnimit joformal.

TABELA 17. KONSTATIME DHE REKOMANDIME LIDHUR ME BASHKËPUNIMIN ME INSTITUCIONE TË TJERA

BASHKËPUNIM ME INSTITUCIONE TË TJERA	
KONSTATIME	REKOMANDIME
▶ Analiza e nevojave e tregut të punës është mjaftë e thelluar, me kohë dhe gjithëpërfshirëse. ▶ Një pjesë e ofertuesve sugjerojnë se ekziston ndikim i fuqishëm politik në kompanitë dhe se kjo ka ndikim mbi dinamikën e zhvillimit të arsimit dhe trajnimeve joformale.	▶ Qasje gjithëpërfshirëse gjatë zbatimit të analizave për nevojat e tregut të punës, si dhe rol të forcuar të APRMV-së me shfrytëzimin e veglave të besueshme metodologjike. ▶ Institucionet kompetente të reagojnë ndaj keqpërdorimeve të ndikimit politik gjatë punësimit dhe arsimit.

3.5. NDJEKJE E CILËSISË GJATË REALIZIMIT TË PROGRAMIT PËR ARSIMIN DHE TRAJNIMINE TË RRIURVE

Ndjekja dhe matja e vazhdueshme e cilësisë së realizimit të programit siguron përfitim afatgjatë, si për ofertuesin dhe pjesëmarrësit në trajnimin, ashtu edhe për sistemin e gjithëmbarshtëm të arsimit joformal për të rritur. Lidhur me këtë çështje, inkurajon fakti që madje 80 për qind e ofertuesve kanë sistem dhe procedura të përcaktuara për kontrollimin e cilësisë. Në të shumtën e rasteve për këtë dedikim ofertuesit përdorin pyetësor për vlerësim që i plotësojnë shfrytëzuesit e trajnimeve, por edhe mekanizma të tjerë të njohur në praktikë, si për shembull teste dhe monitorim i jashtëm.

Shpeshherë, si masë për suksesshmëri të programeve për arsim joformal merret edhe mundësia e personave që e kanë mbaruar trajnimin me sukses të gjejnë punë më lehtë. Sipas të dhënave që janë marrë nga Agjencia për Punësim e Republikës së Maqedonisë së Veriut, përqindja mesatare e punësimeve të pjesëmarrësve në masën për trajnim për profesione të kërkuara arrin rreth 40 për qind, varësisht nga profesioni.

Në raport me rolin e ofertuesve pas përfundimit të trajnimit joformal, konsta-

timi i parë që u imponua është fakti se ofertuesit nuk kanë sistem dhe kapacitete për ndjekjen e pjesëmarrësve në trajnime pas diplomimit të tyre.

Si sfidë imponohet fakti se pas përfundimit të trajnimit, një pjesë e personave të trajnuar hapin biznese të tyre, por nuk e regjistrojnë veprimtarinë, e cila në të shumtën e rasteve zhvillohet në shtëpitë e tyre. Në këtë mënyrë krijojnë konkurrencë jolojale, ndonjëherë madje edhe për vetë ofertuesit. Në këtë drejtim është theksuar se nevojitet respektim i ligjit dhe mbikëqyrje e përforcuar inspektuese.

Sfidë e posaçme që është diskutuar është edhe mënyra e kontrollit të zbatimit real të programeve nga ana e ofertuesve. Në përputhje me Ligjin për arsimin e të rriturve, si subjekte kompetente për kontroll dhe mbikëqyrje në nenin 43 janë Inspektorati Shtetëror i Arsimit (për mbikëqyrje inspektuese dhe mbikëqyrje të cilësisë së punës së enteve, gjegjësisht institucioneve për arsimin e të rriturve), si dhe Qendra për Arsimin e të Rriturve (kompetente për mbikëqyrje profesionale të punës së enteve, gjegjësisht institucioneve për arsimin e të rriturve). Por, këto dy institucione nuk kanë rregulla më precize dhe nevojitet forcim i kapaciteteve të tyre për kontrollin e zbatimit të programeve nga ofertuesit.

Intervistat dhe analizat nga terreni treguan se ka situata kur disa nga pjesëmarrësit në programet janë të motivuar nga përfitimi financiar i mundësuar me masat e Planit operativ, por nuk tregojnë interesim dhe përkushtim gjatë realizimit

të trajnimeve. Në këtë drejtim, nevojitet realizim i koordinuar i mbikëqyrjes edhe mbi procesin e realizimit të trajnimit.

Në kuadër të bisedave, nga të anketuarit janë dhënë ide dhe sugjerime për përmirësimin e konceptit të arsimit joformal:

- 1) Është bërë e ditur nevoja e rritjes së numrit të profesioneve. Sa për krahasim, për dallim nga Gjermania ku ekzistojnë 8000 profesione, në Maqedoninë e Veriut janë evidentuar rreth 500 profesione.
- 2) Është sugjeruar që të shqyrtohet mundësia për kompetenca modulare me kualifikime të ndjekësve të trajnimeve. Me fjalë të tjera, ndjekësi të mos jetë i obliguar të shkojë në të gjitha modulet e trajnimit, por të ketë mundësi të zgjedhë atë që është më adekuate me nevojat e tij. Kjo do të thoshte fleksibilitet më të madh të programeve dhe përshtatje më të lehtë ndaj nevojave të punëdhënësve.
- 3) Lidhur me rolin e transferimeve nga shteti, nga njëra anë është bërë e ditur se nuk mund të barazohet gjithçka me transferimet nga shteti (*“Kjo është njëra prej arsyeve, prandaj dështojnë një numër i madh i ofertuesve të shërbimeve”* – intervistë me ofertues), nga ana tjetër një pjesë e ofertuesve theksuan se *“Disa përvoja komparative tregojnë se nuk është i mundshëm arsimi i të rriturve pa mbështetjen e shtetit”*.

- 4) Një pjesë e ofertuesve marrin pjesë edhe në programet për mobilitet të Komisionit Evropian dhe kanë përvojë të shkëlqyeshme, kështu që u imponua nevoja për promovim më adekuat të mundësive që i ofrojnë këtë programe.
- 5) Nga një pjesë e ofertuesve është bërë e ditur nevoja për mënyrë më transparente të shpërndarjes së mjeteve si dhe kontroll më të madh të realizimit dhe cilësisë së trajnimeve.



TABELA 18. KONSTATIME DHE REKOMANDIME LIDHUR ME PROCESIN E NDJEKJES SË CILËSISË

NDJEKJE E CILËSISË	
KONSTATIME	REKOMANDIME
▶ Inkurajon fakti që madje 80 për qind e ofertuesve kanë sistem dhe procedura të përcaktuara për kontrollimin e cilësisë. ▶ Sipas të dhënave që janë marrë nga APRMV-ja, përqindja mesatare e punësimeve të pjesëmarrësve në masën për trajnim për profesione të kërkuara që kanë të bëjnë me arsimin joformal arrin rreth 40 për qind, varësisht nga profesioni. ▶ Ofertuesit nuk kanë sistem për ndjekjen e pjesëmarrësve në trajnime pas diplomimit të tyre.	▶ Përmes shfrytëzimit të veglave digjitale të ndërmerren disa zgjidhje të caktuara (softuer i specializuar) që do të ndihmonte në sigurimin e mënyrës më transparente të shpërndarjes së mjeteve. ▶ Kontroll më të madh të cilësisë së realizimit të trajnimeve, si dhe përmirësim të sistemit dhe procedurave që i shfrytëzojnë ofertuesit. Cilësia më e madhe e ofertuesve të jetë përparësi gjatë verifikimit të radhës. ▶ Përmirësim i kapaciteteve të institucioneve kompetente për mbikëqyrje inspektuese (ISHA) dhe mbikëqyrje profesionale (QARR). ▶ Forcim të monitorimit që e zbaton APRMV-ja.

3.6. PRAKTIKA TË MIRA

Në bisedat u theksuan disa praktika të mira të arsimit formal në katër rajone të hulumtimit që mund të shërbejnë si bazë për zhvillimin e mëtejshëm të këtij koncepti.

Suksesi i mirë është arritur me trajnimin për serviser të makinave rrobaqepëse, si dhe automekanik për automjete bashkëkohore. Gjithashtu, është i popullarizuar trajnimi përpërkëdhelës/etë personave të rritur. Një pjesë e trajnimeve janë realizuar edhe për persona tashmë të punësuar, ndërsa janë përfshirë edhe persona të papunë.

Pozitiv është shembulli i ofertuesit në Rajonin e Pollogut, i cili ka pasur disa tentime të dështuara që të sigurojë financimin e programit për trajnim. Kur e ka pasur këtë mundësi në vitin 2017, në kaudër të programit të aprovuar është zbatuar trajnim me 14 kandidatë të cilët që të gjithë janë punësuar (një pjesë janë punësuar në kompani, ndërda një pjesë kanë hapur biznese të tyre).

Përkundër kësaj, një pjesë e ofertuesve konsideron se për funksionimin efikas të sistemit të arsimit joformal nevojitet mbështetje e fuqishme e shtetit, ndërsa në bazë të tregut mund të funksionojnë vetëm trajnimet për kontabilitet.

Objekt i interesit tonë ishte edhe përvoja eventuale me organizimin e trajnimeve për grup më të madh “sipas masës së ndjekësve”, por edhe të anketuarit që ishin të përfshirë në këtë hulumtim nuk kishin përvojë me një lloj të kësaj të trajnimit.

TABELA 19. KONSTATIME DHE REKOMANDIME LIDHUR ME PRAKTIKAT E MIRA TË AJFRR-SË

PRAKTIKA MË TË MIRA	
KONSTATIME	REKOMANDIME
▶ Si profile, gjegjësisht trajnime më të suksesshme, janë veçuar trajnimet për servis të makinave rrobaqepëse, si dhe automekanik për automjete bashkëkohore ▶ Gjithashtu, trajnim i popullarizuar, të cilin pjesëmarrësit në trajnime e shikojnë si potencial për të shkuar jashtë vendit është edhe përkëdhelës/e i/e personave të rritur. ▶ Ofertuesit të cilët ishin përfshirë në hulumtimin nuk kanë përvojë me organizimi e trajnimit për grup më të madh sipas masës së iniciatorit.	▶ Të nxiten historitë e suksesshme dhe të promovohen më mirë në opinion. ▶ Të rinovohen procedurat për organizimin e trajnimit me atë që do të lejohet dhe nxitet organizim i trajnimit sipas masës së ndjekësve të trajnimit, mes tjerash edhe përmes zhvillimit të kompetencave modulare në kuadër të një lloji të trajnimit.

3.7. GJITHËPËRFSHIRJE E ARSIMIT DHE TRAJNIMIT JOFORMAL

Gjithëpërfshirja është standard i rëndësishëm në demokracitë moderne që siguron përfshirje më të madhe të kategorive të rrezikuara të popullatës në procesetëndryshmeshoqërore. Merëndësi të posaçme është zbatimi dhe respektimi

i këtij koncepti gjatë krijimit të politikave arsimore, duke përfshirë edhe arsimin e të rriturve dhe arsimin joformal. Në Ligjin për arsimin e të rriturve, në nenin 27, paragrafi 1 parashikohet që pjesëmarrës në programet për arsimin e të rriturve mund të jetë një person që ka mbushur 15 vjet dhe i cili i përmbushë kushtet tjera të parashikuara me programin. Në këtë kuptim, fokusi i hulumtimit është vënë në disa grupe të rrezikuara të popullatës, para së gjithash personat me pengesë,


personat me status të pavoritshëm social, personat që vijnë prej mjediseve rurale dhe persona që i takojnë bashkësisë etnike rome. Të dhënat që kanë të bëjnë me këto grupe janë mbledhur nga intervistat dhe nga anketat me ofertuesit, si dhe nga përgjigjet që janë marrë nga Agjencia për Punësim.

Më i dobët është integrimi i personave me pengesë në arsimin joformal. Nga ofertuesit e anketuar, gjithsej 9 për qind janë përgjigjur se trajnimet që i kanë organizuar janë ndjekur nga persona me pengesë. Madje 73 për qind janë prononcuar se trajnimet e tyre nuk i ndjekin këta persona, ndërsa 18 për qind e ofertuesve nuk kanë evidencë. Nga ana tjetër, përgjigjet që janë marrë nga APRMV-ja tregojnë se në trajnimet e organizuara në kuadër të programit për trajnim të një punëdhënës i njohur dhe programit për kualifikime profesionale sipas kërkesave të punëdhënësve, nuk kanë marrë pjesë fare persona me pengesë. Në vitin 2017, në kuadër të masës për trajnim për profesione të kërkuara, ka marrë pjesë vetëm një person me pengesë, përderisa prej gjithsej 210 pjesëmarrësve në trajnimet për profesione të kërkura nga projekti IPA “Mbështetje për punësimin e të rinjve”, dy persona kanë qenë me pengesë.

Diçka më i mirë është integrimi i personave me status të pavoritshëm socio-ekonomik. Kështu, madje 46 për qind e ofertuesve janë përgjigjur se trajnimet e tyre janë ndjekur nga ana e personave me status të pavoritshëm socio-ekonomik.

GRAFIKON 3. PËRFSHIRJE E PERSONAVE ME STATUS TË PAVORITSHËM SOCIO-EKONOMIK NË AJFRR


A i kanë ndjekur trajnimet tuaja personat me status të pavoritshëm socio-ekonomik?



Thuajse dy të tretat e ofertuesve që janë të verifikuar në përputhje me Ligjin për arsimin e të rriturve kanë theksuar se në trajnimet që i organizojnë kanë marrë pjesë edhe persona të cilët vijnë nga mjediset rurale.

GRAFIKON 4. PËRFSHIRJE E PERSONAVENGA MJEDISET RURALE NË AJFRR


A i kanë ndjekur trajnimet që i organizoni personat prej mjediseve rurale?



Sa i përket strukturës së vizitorëve të ndjekësve, vetë ofertuesit gjatë intervistave bëjnë të ditur se bëhet fjalë për strukturë mjaftë të diversifikuar. Arsimi i tyre lëvizë nga arsimi fillor deri te ai sipëror dhe në të shumtën e rasteve janë të strukturës së përzier etnike (maqedonas, shqiptarë, turq, romë). Përfundimisht, më shumë se gjysma e ofertuesve janë përgjigjur se në trajnimet e tyre kanë marrë pjesë persona të përkatësisë etnike rome.

GRAFIKON 5. PËRFSHIRJE E PERSONAVE ME PËRKATËSI ETNIKE ROME NË AJFRR

A i kanë ndjekur trajnimet që i organizoni persona të përkatësisë etnike rome?



Një pjesë e personave të trajnuar i vizitojnë programet ekskluzivisht për shkak të kompensimit financiar që e marrin. Kjo është theksuar te thuajse të gjithë ofertuesit që ishin të intervistuar. Në Strumicë, është theksuar se ndjekësit e trajnimeve në të shumtën e rasteve janë gra që kanë të mbaruar arsimin e mesëm, edhe atë në të shumtën e rasteve persona më të rinj.

TABELA 20. KONSTATIME DHE REKOMANDIME LIDHUR ME GJITHËPËRFSHIRJEN E PROCESIT TË AJFRR-SË

GJITHËPËRFSHIRJE E PROCESIT TË ARSIMIT JOFORMAL

KONSTATIME

- ▶ Më i dobët është integrimi i personave me pengesë në arsimin joformal.
- ▶ Gjithsej 46 për qind janë përgjigjur se trajnimet e tyre janë ndjekur prej personave me status të pavolitshëm socio-ekonomik.
- ▶ Thuajse dy të tretat e ofertuesve që janë verifikuar në përputhje me LARR-in, kanë theksuar se në trajnimet që i organizojnë kanë marrë pjesë edhe persona që vijnë nga mjediset rurale.
- ▶ Më shumë se gjysma e ofertuesve janë përgjigjur se në trajnimet e tyre kanë marrë pjesë persona të përkatësisë etnike rome.

REKOMANDIME

- ▶ Nevojitet të avancohet gjithëpërfshirja e personave nga grupet e marginalizuara, e para së gjithash të rritet pjesëmarrja e personave me pengesë në trajnimet nga arsimi joformal.
- ▶ Në zhvillimin e programeve dhe masave të ardhshme domosdoshmërisht t'i kushtohet kujdes qasjes më të madhe të arsimit joformal për grupet e rrezikuara dhe për gjithëpërfshirjen e tyre.
- ▶ Të promovohen universitete qytetare për mësim të përjetshëm si ofertues që janë më shumë të kapshëm në vendet më të vogla.

3.8. FINANCIMI I ARSIMIT DHE TRAJNIMIT JOFORMAL

Financimi i arsimit të të rriturve në Republikën e Maqedonisë së Veriut sigurohet përmes mjeteve publike dhe private.

Mjetet publike për financimin e AJFRR-së rrjedhin nga Buxheti i RMV-së, gjegjësisht buxhetet e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale. Nga Buxheti i RMV-së sigurohen mjete për: shpenzimet për realizimin e programeve për arsimin e detyrueshëm të të rriturve, shpenzimet për arsim fillor, gjegjësisht programe të tjera të arsimit, mirëmbajtje rrjedhëse të institucioneve për arsimin e të rriturve themelues i të cilave është shteti dhe shpenzimet për ndjekjen, avancimin dhe zhvillimin e arsimit të të rriturve.²¹ Nga buxhetet e njësive të vetëqeverisjes lokale sigurohen mjete për: shpenzime që kanë të bëjnë me realizimin e programeve në institucionet për arsimin e të rriturve themelues i të cilave është Njësia e Vetëqeverisjes Lokale, mirëmbajtje rrjedhëse të institucioneve për arsimin e të rriturve themelues i të cilave është Njësia e Vetëqeverisjes Lokale dhe investime në institucione për arsimin e të rriturve themelues i të cilave është Njësia e Vetëqeverisjes Lokale.²²

Nga ana tjetër, ofertuesit e shërbimeve mund të sigurojnë edhe mjete personale (private) për financimin dhe nxitjen e arsimit të të rriturve. Në rastin e arsimit joformal, ofertuesit këto mjete i sigurojnë kryesisht përmes arkëtimit të kompensimit për pjesëmarrje në trajnim nga pjesëmarrësit ose nga punëdhënësit, tëpunësuarit e të cilëve indjekin trajnimet. Një pjesë e ofertuesve të AJFRR-së janë financuar edhe prej kompanive të tjera ose burimeve të tjera.

Nga përgjigjet e pyetjeve nga anketa dhe intervistat me ofertuesit, si dhe përgjigjeve në pyetjet e përfshira në kërkesat për qasje të lirë deri te informacionet e karakterit publik që janë marrë nga APRMV-ja, është vërejtur se financimi i verifikimit të ofertuesve në vitin 2017 është siguruar kryesisht nga mjetet publike. Financimi shtetëror i arsimit joformal zhvillohet para së gjithash përmes programeve dhe masave të përfshira në Planin operativ për programe dhe masa aktive për punësim dhe shërbime të tregut të punës për vitin 2017 (në vazhdim: PO). Qëllimi i programeve, masave dhe shërbimeve për punësim të përfshira në PO-në janë orientuar drejt përmirësimit të funksionimit të tregut të punës, sigurimit të mbështetjes për krijimin e vendeve të reja të punës dhe rritjen e punësimit të personave të papunë.

21 Neni 30 nga Ligji për Arsimin e të Rriturve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 7/2008, 17/2011, 51/2011, 74/2012, 41/2014, 144/2014, 146/2015, 30/2016 dhe 64/2018)

22 Ibid. Neni 31

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale e udhëheq PO-në, derisa realizimi i tij është i koordinuar nga ana e APRMV-së, në partneritet me:

- ➔ Institucione: Ministria e Arimit dhe Shkencës (MASH), Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës (MSHIA), Qendra për Arsim dhe Trajnim Profesional (QATP), Qendra për Arsimin e të Rriturve (QARR), Agjencia për Mbështetjen e Sipërmarrësisë (AMS), Institucionet dhe Entet Arsimore (IEA), Qendrat për Punë Sociale (QPS); dhe
- ➔ Organizata të tjera: Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP), Banka Botërore (BB), Qendra Informative Rome (QIR), Qendra e certifikimit për IT trajnim dhe mekanizmat lokale për barazi gjinore (koordinatorë për mundësi të barabarta në njësitë e vetëqeverisjes lokale)²³.

Rrezja e veprimit e PO-së në vitin 2017 i përfshinte programet, gjegjësisht masat vijuese:

- 1) zhvillim të veprimtarisë sipërmarrëse;
- 2) punësim i subvencionuar;
- 3) trajnime;
- 4) punë e dobishme në komunë;
- 5) pilot-programe;
- 6) shërbime për punësim;
- 7) anketa për nevojën e shkathtësive në tregun e punës.

Në vazhdim janë prezantuar numri i pjesëmarrësve në trajnimet që janë të organizuara në kuadër të programeve të verifikuara për arsimin e të rriturve përmes APRMV-së. Thuajse 1000 persona janë trajnuar për profesione të kërkuara dhe përmirësimin e shkathtësive për punësim në kuadër të masës për trajnime për profesione të kërkuara dhe në projektin IPA “Mbështetje për punësimin e të rinjve” në rajonin e Shkupit, Pollogut, Juglindjes dhe Jugperëndimit. Më shumë se 560 persona kanë ndjekur programe të paverifikuara për arsimin e të rriturve përmes Agjencisë për Punësim në vitin 2017.

²³ Agjencia për Punësim e Republikës së Maqedonisë, Plan i riveduar operativ për programe dhe masa aktive për punësim dhe shërbime të tregut të punës për vitin 2017, E kapshme në: <http://av.gov.mk/content/%D0%9E%D0%9F/Revidiran%20Operativen%20plan%20za%20izmena%20i%20dopolnuvane%20na%20OP%202017.pdf> [qasje më 21 shkurt të vitit 2019].

TABELA 21. NUMRI I PERSONAVE QË KANË NDJEKUR PROGRAME TË VERIFIKUARA
PËR ARSIMIN E TË RRITURVE PËRMES APRMV-SË NË VITIN 2017 SIPAS RAJONEVE

RAJON	TRAJNIM PËR PROFESIONE TË KËRKUARA	PROJEKTI IPA „MBËSHTETJE PËR PUNIMIN E TË RINJVE“			GJITHSEJ
		Komponenti B: Trajnime për profesione të kërkua në tregun e punës	Komponenti C: Mbështetje dhe këshillim për veprimtari sipërmarrëse	Komponenti D: Trajnime për përgatitje për punësim dhe shkathtësi për kërkim të punës	
Rajon i Shkupit	23	51	180	108	362
Rajoni i Pollogut	48	3	249	56	356
Rajoni juglindor	10	0	73	51	134
Rajoni jugperëndimor	0	4	24	107	135
GJITHSEJ	81	58	526	322	987

Burimi: APRMV.

TABELA 22. NUMRI I PJESËMARRËSVE NË PROGRAMET E PAVERIFIKUARA
PËR ARSIMIN E TË RRITURVE PËRMES APRMV-SË NË VITIN 2017

RAJON	PJESËMARRËS NË MASËN 3.4 TRAJNIM PËR IT SHKATHTËSI TË AVANCUARA	PJESËMARRËS NË MASËN 3.4 TRAJNIM PËR IT SHKATHTËSI TË AVANCUARA (IPA)	PJESËMARRËS NË MASËN 3.8.A TRAJNIM PËR SHKATHTËSI THEMELORE (GJUHË TË HUAJA)	PJESËMARRËS NË MASËN 3.8.B TRAJNIME PËR SHKATHTËSI THEMELORE (KOMPJUTERË)	PJESËMARRËS NË MASËN 3.8.B TRAJNIME PËR SHKATHTËSI THEMELORE (KOMPJUTERË)
Rajoni i Shkupit	53	93	182	116	444
Rajoni i Pollogut	6	16	50	0	72
Rajoni juglindor	2	5	2	0	9
Rajoni jugperëndimor	6	12	19	0	37
GJITHSEJ	67	126	253	116	562

Burimi: APRMV.

Lidhur me përcaktimin e strukturës së të ardhurave të përgjithshme të realizuara në vitin 2017 të ofertuesve që ishin të përfshirë në anketën, është konstatuar reagim i dobët i tyre.

Vetëm katër ofertues (prej gjithsej 15 të anketuarve) u përgjigjën në pyetjen e parashtruar – *Sa për qind nga të ardhurat e përgjithshme të realizuara në vitin 2017 janë realizuar prej burimeve të ndryshme: pjesëmarrësit në trajnime për arsimin e të rriturve; buxhet i RMV-së (duke përfshirë edhe Planin operativ të APRMV-së); buxhet i komunës; donacione dhe projekte nga burimet e huaja; burime të tjera?*

Nga përgjigjet që janë marrë vetëm dy ishin të plota, derisa dy ofertues janë përgjigjur pjesërisht. Në vazhdim janë paraqitur përgjigjet e ofertuesve në tërësi:

- **I anketuari 1:** Prej 50 deri 60% e të ardhurave të realizuara në vitin 2017 janë realizuar përmes donacioneve dhe projekteve të huaja, pjesa tjetër (30% - 40%) janë të ardhura prej burimeve të tjera.
- **I anketuari 2:** Prej 70% deri 80% e të ardhurave të përgjithshme janë realizuar nga pjesëmarrësit në arsimin e të rriturve të cilët paguajnë kompensim të caktuar; pjesa e mbetur janë të ardhura nga buxheti qendror (duke i përfshirë edhe programet për punësim të APRMV-së).
- **I anketuari 3:** Të ardhurat nga buxheti i RMV-së (duke përfshirë edhe

programet për punësim të APRMV-së) marrin pjesë me më pak se 10% në të ardhurat e përgjithshme të vitit 2017.

- **I anketuari 4:** Më pak se 10% e të ardhurave të përgjithshme janë realizuar prej donacioneve dhe projekteve nga burimet e huaja..

Edhe prej këtyre pak përgjigjeve, mund të konstatohet se në sistemin e arsimit dhe trajnimit joformal të të rriturve është i pranishëm edhe financimi që nuk është nga mjetet publike (buxheti i RMV-së ose buxheti i komunës).

Për nevojat e këtij hulumtimi jemi fokusuar në disa programe, gjegjësisht masa të përfshira në PO-në që janë të lidhura në mënyrë direkte ose indirekte me arsimin joformal. Kështu, janë identifikuar 5 (pesë) masat, gjegjësisht programet vijuese, nga PO-ja për vitin 2017:

- 1) Trajnim për profesione të kërkuara;
- 2) Projekti IPA „Mbështetje për punësimin e të rinjve“, Komponenti B: Trajnim për profesione të kërkuara në tregun e punës;
- 3) Trajnim të ndonjë punëdhënës i njohur;
- 4) Pilot-program për trajnim për plotësimin e nevojave lokale nga fuqia e kualifikuar e punës; dhe
- 5) Trajnim për zeje.

Në vitin 2017, në rajonet me interes të Projektit, gjithsej 252 personakanë marrë pjesë në trajnimin e organizuar në kuadër të ndonjëres prej pesë masave, gjegjësisht

programeve të përmendura. Shuma e përgjithshme e mjeteve të paguara nga PO-ja arrin në 13.484.042 denarë, prej të cilave 7.065.475 denarë (52,4 %) u janë paguar realizuesve të trajnimeve, derisa 6.418.567 (47,6 %) denarë pjesëmarrësve në trajnimet. Në mesatare, për një pjesëmarrës në trajnim në vitin 2017 janë paguar 25.470 denarë.

Në Tabelën 23 janë paraqitur treguesit e hollësishëm për numrin e pjesëmarrësve dhe mjetet e paguara nga PO-ja, në rajonin e Shkupit, Pollogut, Juglindjes dhe Jugperëndimit në vitin 2017.

TABELA 23. TË DHËNA PËRMBLEDHËSE PËR MASA DHE PROGRAME TË ZGJEDHURA NGA PO-JA QË KANË TË BËJNË ME AJFRR-NË NË VITIN 2017

MASA	NUMRI I PJESË-MARRËSVE	GJITHSEJ MJE TE TË PAGUARA (NË MKD)	GJITHSEJ MJE TE TË PAGUARA PËR REALIZUESIT (NË MKD)	GJITHSEJ MJE TE TË PAGUARA PËR PJESËMARRËSIT (NË MKD)	MJETE TË PAGUARA PËR PJESË-MARRËS (NË MKD)
Trajnim për profesione të kërkuara	81	4.258.981	2.334.998	1.923.983	23.753
Projekti IPA „Mbështetje për punësimin e të rinjve“, Kompoenti B: Trajnime për profesione të kërkuara në tregun e punës	66	3.087.500	1.899.500	1.188.000	18.000
Trajnim të punëdhënës i njohur	19	503.347	22.763	480.584	25.294
Pilot-program për trajnim për plotësimin e nevojave lokale për fuqi të kualifikuar punëtore	24	1.368.000	720.000	648.000	27.000
Trajnim për zeje	62	4.266.214	2.088.214	2.178.000	35.129
GJITHSEJ	252	13.484.042	7.065.475	6.418.567	25.470

Burimi: APRMV.

Shënim: Të dhënat kanë të bëjnë me katër rajonet e planifikimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut (Juglindor, Jugperëndimor, Pollog dhe Shkup).

A. Trajnim i profesioneve të kërkuara

Për masën e trajnimit për profesionet e kërkuara në vitin 2017 janë paraqitur gjithsej 289 persona, prej të cilëve janë përfshirë gjithsej 127 persona. Në kuadër të kësaj mase janë realizuar trajnime për profesionet vijuese: kuzhinier, pastičer, rrobaqepës, argon-saldues, drejtues i makinave ndërtimore, drejtues i makinës për ngarkim-shkarkim, automekanik për sisteme bashkëkohore të automjetet motorike, përpunues i produkteve dhe konstruksioneve të bravave, drejtues i ekskavatorit dhe makinave për ngarkim dhe buldozherë.

Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në trajnimet e organizuara në ndonjërin prej

qyteteve Shkup, Strumicë ose Tetovë arrin 81 persona.

Në kuadër të PO-së, për masën për trajnim për profesionet e kërkuara, ku realizuesit e trajnimit kanë programe të verifikuara paraprakisht, janë paguar gjithsej 4.258.981 denarë. Prej tyre, përafërsisht 2,3 milionë denarë janë mjete që u janë paguar realizuesve, derisa pjesëmarrësit kanë marrë gati se 2 milionë denarë. Në masën për trajnim për profesionet e kërkuara, kushti themelor për pjesëmarrje të realizuesve të trajnimit është që të jenë të verifikuar nga MASH-i, për program të verifikuar paraprakisht nga QARR-i. Të dhënat për shpërndarjen sipas rajoneve janë paraqitur në Tabelën 24.

TABELA 24. PASQYRË E REALIZIMIT TË MASËS PËR TRAJNIM PËR PROFESIONE TË KËRKUARA

RAJON	QYTETI	PROFESIONI	NUMRI I PJESËMARRËSVE	MJETE TË PAGUARA PËR REALIZUESIT (NË MKD)	MJETE TË PAGUARA PËR PJESËMARRËSIT (NË MKD)	MJETE TË PAGUARA PËR PJESËMARRËS (NË MKD)	GJITHSEJ MJETE TË PAGUARA (NË MKD)
Rajoni i Shkupit	Shkup	Rrobaqepës, drejtues i mjetit për ngarkim-shkarkim, argon saldues	23	624.998	509.529	22.153	1.134.527
Rajoni Juglindor	Strumicë	Drejtues i ekskavatorit, makinave për ngarkim dhe buldozherë	10	290.000	229.400	22.940	519.400
Rajoni i Pollogut	Tetovë	Kuzhinier; pastičer; rrobaqepës; argon-saldues; automekanik	48	1.420.000	1.185.054	24.688	2.605.054
GJITHSEJ			81	2.334.998	1.923.983	23.753	4.258.981

Me qëllim që të përcaktohet kontributi i përgjithshëm i arsimit joformal i nxitur nga shteti në formë të trajnimeve për profesione të kërkuara, janë përllogaritur dy variabla plotësuese.

- ➔ Variabla e parë e paraqet pjesëmarrjen e mbështetjes shtetërore të realizuesve të trajnimeve të siguruar përmes APRMV-së në raport me të ardhurat e përgjithshme të kompanive. Është përllogaritur si raport mes mjeteve të përgjithshme të ndara për të gjithë realizuesit e trajnimeve në kuadër të një qyteti dhe përmblendhje e të ardhurave të përgjithshme të realizuesve. Të dhënat për të ardhurat e përgjithshme janë marrë nga bilanci e suksesit që janë përfshirë në raportin vjetor për punën financiare për vitin 2017, për secilin ofertues ndaras.

Listat nga llogaritë e përpunuara vjetore (bilanc i suksesit dhe bilanc i gjendjes) janë marrë nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

- ➔ Variabla e dytë paraqet se sa mjete janë ndarë në mesatare për pjesëmarrësit në trajnimet dhe është përllogaritur si raport mes shumës së mjeteve të paguara nga PO-ja për pjesëmarrësit në trajnimet dhe numrin e përgjithshëm të pjesëmarrësve në trajnime. Përllogaritjet janë bërë për secilin prej qyteteve në të cilat janë realizuar trajnime në vitin 2017, e të cilat u takojnë rajoneve me interes të projektit E4E@mk(Shkup, Tetovë dhe Strumicë). Në raport me këtë masë nuk ishin të kapshme të dhëna për mjete të ndara për secilin realizues të trajnimeve ndaras.

TABELA 25. PJESEMARRJE E MJETEVE TË PAGUARA NGA PO-JA NË TË ARDHURAT E PËRGJITHSHME TË OFERTUESVE NË VITIN 2017 SIPAS RAJONEVE

RAJON	QYTET	PJESEMARRJE E MJETEVE TË PAGUARA NGA APRMV-JA NË TË ARDHURAT E PËRGJITHSHME TË REALIZUESVE TË TRAJNIMEVE	MJETE TË PAGUARA PËR PJESEMARRËS (MESATARE NË MKD)
Rajoni i Shkupit	Shkup	0,01%	22.153
Rajoni juglindor	Strumicë	1,26%	22.940
Rajoni i Pollogut	Tetovë	0,86%	24.689

Burimi: Llogari përfundimtare të realizuesve të trajnimeve dhe të dhëna që janë marrë nga APRM-ja.

Nga tabela mund të vërehet se pjesëmarrje relativisht më të lartë të mjeteve të paguara nga APRMV-ja në kuadër të programit për trajnime për profesione të kërkuara në të ardhurat e përgjithshme të ofertuesve ka në rajonin juglindor, derisa më të ulët në atë të Shkupit. Kjo pjesërisht ka të bëjë edhe me madhësinë e ndryshme të ofertuesve të cilëve u janë ndarë mjete në rajonet e ndryshme. Nga ana tjetër, shuma mesatare e mjeteve të paguara për pjesëmarrës në trajnim është më e madhe në rajonin e Pollogut, ndërsa më e vogël në atë të Shkupit.

Në kuadër të projektit IPA “Mbështetje për punësimin e të rinjve”, Komponenta B: trajnime për profesione të kërkuara në tregun e punës në vitin 2017 janë përfshirë gjithsej 210 persona të papunë, derisa numri i aplikacioneve të mbërritura arrin 861. Në kuadër të këtij komponenti janë realizuar katër trajnime të ndryshme: nëpunës në kontabilitet, grimues, masazher dhe përkëdhelës/e i/e personave të vjetër dhe të pafuqishëm në kushte shtëpiake.

Në raport me rajonet në të interes të projektit E4E@mk, vetëm në Shkup, gjegjësisht në rajonin e Shkupit janë organizuar trajnime të mbështetura me projektin IPA “Mbështetje për punësimin e të rinjve”. Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në trajnimet në Shkup ka arritur në 66 persona, prej të cilëve 35 kanë ndjekur trajnim për nëpunës në kontabilitet, derisa 31 persona kanë ndjekur trajnim nga fusha e shërbimeve personale (trajnim për grimues ose trajnim për masazher). Shuma e përgjithshme e mjeteve të ndara për këtë masë në Shkup

arrin 3.087.500 denarë, prej të cilëve 1.899.500 denarë kanë qenë të dedikuara për realizuesit, ndërsa 1.188.000 denarë për pjesëmarrësit në trajnime.

Edhe në këtë rast, është interesante të krahasohen situatat nga aspekti i pjesëmarrjes së mjeteve të ndara të ofertuesve në të ardhurat e tyre të përgjithshme, si dhe shuma mesatare e mjeteve për pjesëmarrës në trajnim. Kështu, kalkulimet tregojnë se mjetet që i kanë marrë ofertuesit nga projekti IPA, arrijnë 1,7% të të ardhurave të tyre të përgjithshme. Në mesatare, përmes kësaj mase janë veçuar 18.000 denarë për pjesëmarrës në trajnim.

B. Trajnim te punëdhënësi i njohur

Në vitin 2017, në kuadër të programit për trajnim te punëdhënësi i njohur, kanë marrë pjesë gjithsej 28 persona. Për pjesëmarrje në këtë program në vitin e njëjtë janë lajmëruar gjithsej 77 persona të papunë. Në programin kanë marrë pjesë edhe 19 punëdhënës me veprimtari të ndryshme (industria përpunuese, veprimtari profesionale, shkencore dhe teknike, ndërtimtari, tregti me pakicë dhe shumicë dhe veprimtari të tjerashërbyese). Shuma e përgjithshme e mjeteve të shpenzuara për këtë masë në vitin 2017 arrin 750.476 denarë, prej të cilëve për persona që e kanë ndjekur trajnimin janë paguar gjithsej 717.001 denarë, ndërsa punëdhënësve të përfshirë në programin u janë paguar 33.475 denarë. Në vazhdim janë dhënë karakteristika përmblledhëse të masës së realizuara në qendrat për punësim që bëjnë pjesë në rajonet e planifikuara në interes të projektit.

TABELA 26. PASQYRË E REALIZIMIT TË MASËS PËR TRAJNIM TE PUNËDHËNËSI I NJOHUR

QENDRA PËR PUNËSIM	APLIKACIONE NGA PERSONAT	KONTRATA ME PERSONAT	SHUMA PËR PERSONAT (NË MKD)	SHUMA PËR PERSON (NË MKD)	SHUMË PËR NDËRMARRJEN (NË MKD)	GJITHSEJ (NË MKD)
Ohër	7	6	150.545	25.090	6.695	157.240
Shkup	29	4	122.065	30.516	6.695	128.760
Strumicë	18	9	207.974	23.108	9.373	217.347

Burimi: APRMV.

C. Pilot-program për trajnimin për plotësimin e nevojave lokale nga fuqia e klasifikuar punëtore

Në kuadër të këtij pilot-programi kanë marrë pjesë gjithsej 24 persona, ndërsa në shpalljen publike janë lajmëruar gjithsej 48 persona. Në kuadër të programit janë realizuar dy lloje të trajnimeve edhe atë: serviser për sisteme mehatronike në Ohër dhe përpunues i brumrave në Prilep. Këto programe nuk janë të verifikuara sipas Ligjit për arsimin e të rriturve, meqë pilot programi, ka të bëjë me shkollat e mesme, me ç'ras qëllimi është që kuadri mësimor të fillojë me proceset e prodhimit te punëdhënësit. Gjithsej për këtë program janë shpenzuar 1.368.000 denarë, prej të cilëve, 720.000 denarë u janë dhënë realizuesve të trajnimeve, ndërsa 648.000 denarë u janë paguar personave që kanë marrë pjesë në trajnimet.

Ç. Trajnim për zejtar

Në masën për trajnim për zejtar janë përfshirë 62 persona të papunë, ndërsa janë lajmëruar gjithsej 104. Trajnimet që janë realizuar kanë të bëjnë me përpunimin e stolive prej monistëve, qëndisje dhe endje artizanale, pikturim në qelq, përpunim të vitrazheve, orëndreqës dhe teneqepunues. Për këtë masë janë shpenzuar gjithsej 4.266.214 denarë, prej të cilave 2.088.214 denarë u janë paguar realizuesve të trajnimeve, ndërsa 2.178.000 denarë pjesëmarrësve në trajnimet (mesatarisht 68.810 denarë për person).



TABELA 27. KONSTATIME DHE REKOMANDIME LIDHUR ME FINANCIMIN E AJFRR-SË**FINANCIM I ARSIMIT JOFORMAL****KONSTATIME**

- ▶ Financimi i AJFRR-së është kryesisht shtetëror dhe zhvillohet përmes PO-së.
- ▶ Në rajonet e projektit E4E@mk, gjithsej 987 persona kanë ndjekur trajnimin për programe të verifikuara përmes APRMV-së në vitin 2017 dhe 562 persona kanë marrë pjesë në programe të paverifikuara përmes APRMV.
- ▶ Në PO-në vitit 2017 janë identifikuar pesë masa, gjegjësisht programe, që janë të lidhura në mënyrë me AJFRR-në. Në katër rajonet e projektit, gjithsej 252 persona kanë marrë pjesë në trajnimin e organizuar në kuadër të ndonjërës nga këto masa/programe. Shuma e përgjithshme e mjeteve të paguara nga PO-ja arrin 13.484.042 denarë, edhe atë 7.065.475 denarë për realizuesit e trajnimeve, ndërsa 6.418.567 denarë për pjesëmarrësit në trajnimet. Në mesatare, për një pjesëmarrës në trajnim në vitin 2017 janë paguar 25.470 denarë.
- ▶ Gjithsej 4,3 milionë denarë janë shpenzuar për realizuesit e trajnimeve dhe për pjesëmarrësit në trajnimet në vitin 2017 në kuadër të masës për trajnimin e profesioneve të kërkuara. Me këtë masë janë përfshirë gjithsej 81 pjesëmarrës nga rajonet në interes të projektit E4E@mk.
- ▶ Për trajnim të punëdhënësi i njohur janë ndarë gjithsej 750.476 denarë nga PO-ja për organizimin e trajnimeve të ndjekura prej 28 persona. Në kuadër të pilot-programit për trajnim për plotësimin e nevojave lokale për fuqi të kualifikuar të punës janë ndarë 1.368.000 denarë. Trajnime në vitin 2017 i kanë ndjekur gjithsej 24 persona. Në masën trajnim të zejtarisë janë përfshirë 62 personatë papunë dhe janë shpenzuar 4.266.214 denarë.

REKOMANDIME

- ▶ Nevojitet të nxitet iniciativa private që ofertuesit në mënyrë të pavarur t'i organizojnë, t'i rinovojnë dhe t'i financojnë trajnimet në arsimin joformal.
- ▶ APRMV-ja të vazhdojë të jetë e përfshirë përmes PO-së në financimin e arsimit joformal, por me tendencë që mbështetja shtetërore me kalimin e kohës të zvogëlohet dhe të zëvendësohet me arsim të qëndrueshëm joformal të financuar privatisht.
- ▶ Nevojitet promovim më adekuat i mundësive që i ofrojnë programet e financuara nga BE-ja, e të cilat kanë të bëjnë me arsimin joformal në vend.

BIBLIOGRAFI

- Agjencia për Punësim e Republikës së Maqedonisë, Plan i reviduar operativ për programe dhe masa aktive për punësim dhe shërbime të tregut të punës për vitin 2017, E kapshme në: <http://av.gov.mk/content/%D0%9E%D0%9F/Revidiran%20Operativen%20plan%20za%20izmena%20i%20dopolnuvane%20na%20OP%202017.pdf> [qasja më 21 shkurt të vitit 2019].
- Anketë për arsimin e personave të rritur, 2016. Shkup, Enti Shtetëror për Statistikë.
- Ligj për Arsimin e të Rriturve („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 7/2008, 17/2011, 51/2011, 74/2012, 41/2014, 144/2014, 146/2015, 30/2016 dhe 64/2018).
- Ligj për universitetet e hapura qytetare për mësim të përjetshëm („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 36/2011, 41/2014, 145/2015, 55/2016 dhe 64/2018).
- Koncepcioni për arsim joformal dhe mësim informal nga viti 2015.
- Komisioni Rregullator (BE) nr.823/2010, nr.1175/2014 dhe Rregullativa(BE) nr.452/2008.
- Republika e Maqedonisë, Strategji për arsim viti 2018-2025 dhe Plan veprimi, i kapshëm <http://www.mon.gov.mk/index.php/2014-07-23-14-03-24/vesti-i-nastani/2549-2018-2044> [qasje më 23 shkurt të viti 2019].
- Republika e Maqedonisë, Strategji për arsimin e të rriturve viti 2016 – 2020, Shkup, 2016 e kapshme në http://www.mon.gov.mk/images/AE_STRATEGY_MK_Final_1-min.pdf [qasje më 22 shkurt 2019].
- Klasifikim nacional i profesioneve. Shkup: Enti Shtetëror për Statistikë i Republikës së Maqedonisë, 2015. I kapshëm në: <http://www.stat.gov.mk/KlasifikaciiNomenklaturi.aspx?id=15> [qasje më 10 mars të vitit 2019].

